

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7653 E diel 16 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Slobodan Milosheviçi e anuloi dhunshëm autonominë e Kosovës më 1989, duke vendosur masa të jashtëzakonshme. Serbia e okupoji Kosovën gjatë ...
Vijon në faqen 21

Nga VETON SURROI

Thaçi dhe Vuçic, çdokush që e lexoi këtë përrallë e ka gabim



Opinion i Ditës

15 shtatori është Dita Ndërkombëtare e Demokracisë. Dikur ishte ditë me simbolikë të madhe, frymëzuese dhe reflektuese. Tani "demokracia" ...
Vijon në faqen 22

Nga AFRIM KRASNIQI

Dita e Demokracisë, Shqipëria peng i një elite konsensuale korruptive



Policia: Mjeti nuk u nis nga Shqipëria

Sekuestrohet skafi me 1.7 tonë drogë në Itali, në pranga 2 shqiptarë

Prokurori i Antimafias: Mafia nigeriane dhe ajo shqiptare bëjnë ligjin në territorin tonë

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, policia italiane ka sekuestruar një skaf me 1.7 tonë kanabis, ndërsa kanë përfunduar në pranga dy shqiptarë. Sipas "Guardia di Finanza"-s, operacioni i sekuestrimit të gomones me drogë është ekzekutuar nga reparti ajror detar i financës italiane të rajonit të Pulias, Molises ...
Në faqen 6

PERPLASJA/ AKUZA E PD: KAZINOTE JANE TE LIDHURA ME EKZEKUTIVIN

QEVERIA: PROJEKT PER TE KUFIZUAR BASTET

Drejtori i Komunikimit në Kryeministri, Endri Fuga: Rama-Xhafaj s'kanë lidhje me kompanitë. Enkelejd Alibeaj: U shtuan 2.176 pika bastesh në të gjithë vendin



(Në foto) Enkelejd Alibeaj gjatë një konference shtypi. Drejtori i Komunikimit në Kryeministri, Endri Fuga



Në faqen 3

ZONAT INFORMALE

Lista e ALUIZNI: Emrat, 950 lejet e legalizimit në qarkun e Shkodrës

Në faqet 10-11

DEMSPERBLIMI

Hidrocentrali i Kalivaçit, Beketi do t'i paguajë 7 mln euro Shqipërisë

Në faqen 8

KREU I PDIU

Shpëtim Idrizi: Nuk kemi asnjë problem me kauzën e Vangjel Dules

Në faqen 2

SARANDE

Plagoset truproja e diskos, si u shpëtoi më herët 3 atentateve

Në faqen 6

MESAZHET



Lu: Demokracia na bashkon të gjithëve. Meta: Të rinjtë, në krye të integrimi

Në faqen 4



"Përveç komunizmit, teatri nuk i përmbushi kurrë pritshmëritë e pushtetit"

Arian Leka: Teatri si formë ndëshkimi

Në brendësi: Festivali i të drejtave, nga Ben Andoni. Poezi nga Petraq Risto

NGA ARIAN LEKA

Nuk dua që ta ndërpresësh pa e filluar leximin. Aq më pak të pandehësh se dashkam të të them diçka poetike, si zakonisht. Po të them se i besoj prej kohësh vargut të Sting-ut, i cilit ngulmon të na thotë se dhuna nuk është



zgjdhje, se asgjë nuk vjen nga dhuna dhe asgjë e mirë nuk mund të vijë kurrë prej saj. Po ja që ashtu nisi. Në mënyrë të dhunshme. Teatri do të shembet! Shoqëruar me pikëçuditëse, siç e do drejtshkrimi i mbrojtur me ligj. Zhvendosur ...

Suplement

KOALICIONET REAGIMET

Zgjedhjet lokale, kreu i grupit të PS reklamon ndryshimin e Belshit

Balla, Bashës: Do të drejtojmë edhe bashkitë që ti i mban peng

Kryetari i grupit të Partisë Socialiste, Taulant Balla i bëri të qartë dje kreut të opozitës se PS do të marrë drejtimin edhe të atyre bashkive që mbahen peng nga PD. Ndërsa ka publikuar disa foto nga qyteti i Belshit, për të treguar sesi është transformuar duke u kthyer në një destinacion të rëndësishëm turistik, Balla shkroi në rrjetin social: "Kush e mban mend si ishte Belshi vetëm tri vite më parë, kur drejtohej nga partia e Lulit dhe si është transformuar". E ndërsa vitin tjetër do të zhvillohen zgjedhjet lokale, Balla shprehet se PS do të marrë përgjegjësinë e ndryshimit të drejtimin edhe në bashki të tjera të vendit, të cilat prej vitesh janë peng i modelit Lulzim Basha: "Krye-



tari fle vetëm gjumë". Ndër bashkitë kryesore që drejtohen nga të zgjedhurit e PD janë Shkodra, Kukësi dhe Pogradeci. "Tashmë, Belshi i rilindur tërësisht është një destinacion i rëndësishëm

turistik në qarkun e Elbasanit. Dje dhe sot zhvillohet në Belsh festa 'Nimfa e Liqeneve'. Panairi i prodhimeve bujqësore, koncerte folklorike dhe sigurisht, mikpritja e popullit të kësaj zone

nuk duhen humbur. Kush e mban mend si ishte Belshi vetëm tri vite më parë kur drejtohej nga partia e Lulit dhe si është transformuar sot nën drejtimin e Arif Tafanit, me mbështetjen e plotë të kryeministrit Edi Rama, diferenca është si nata me ditën. Edhe 240 ditë na ndajnë nga zgjedhjet vendore 2019, kur duhet të marrim përgjegjësinë e ndryshimit të drejtimin edhe në bashki të tjera të vendit, të cilat prej vitesh janë peng i modelit Lulzim Basha, 'kryetari fle vetëm gjumë', u shpreh Balla.



Gjatë një seance parlamentare

Kreu i PDIU-së sqaron bisedimet për aleancë me PD-në: "Sot takoj Bashën, më pas marrëveshje me të gjithë aleatët"

Shpëtim Idrizi: S'kam asnjë problem me Dulen

Largimi i deputetëve, kreu i PDIU kërkon falje publike pse i vuri në listë

Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi ka folur për largimin nga PS si dhe kalimin në opozitë me PD. I ftuar në emisionin "Kjo Javë" me Nisida Tufën në "News 24", Idrizi tha se mandatet e PDIU janë vjedhur nga kjo mazhorancë gjatë zgjedhjeve, ndërsa PDIU nuk ka qenë pjesë e qeverisjes. Idrizi tha se çështja çame është lënë jashtë diskutimeve mes Greqisë dhe Shqipërisë. "Flitet për një ikje nga PS. Ne nuk kemi ikur nga askush. Ne nuk jemi pjesë e qeverisjes. Mandatet e PDIU janë vjedhur nga kjo mazhorancë. Ne kemi parë një sjellje jo korrekte me PDIU, pra në këtë kuptim me gjatë gjithë kohës kemi qenë në opozitë dhe të shkojmë zyrtarisht me opozitën. Ne u goditëm nga kjo mazhorancë me mandatin e Tiranës dhe të Fierit. Ne prisnim të zgjidhej çështja çame, ndërsa mes palëve diskutohet nëse duhet të ishte apo jo çështja çame në bisedime. Pra, lënia jashtë e çështjes çame është e papranueshme. Bushati nuk kërkon të na takojë për çështjen çame. Një shtet rrumpallë, edhe po të dojë ta marrë baba im pasaportën, nuk e arrin dot", - tha Idrizi gjatë intervistës. Sipas Idrizit, deputetë që tashmë janë me mazhorancën, nuk e kanë



Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi

ditur as emrin Çamëri. Ai pranon se edhe ai ka gabuar dhe këtë e sheh tek moskontrolli i emrave në lista, sepse shton se nuk besonin se do të merrte aq deputetë në zgjedhje. "Kanë një vit, jo vetëm që nuk kanë folur për çështjen çame, por edhe sot po t'i pyesësh se ku janë zyrat, ata nuk i dinë. Pa dyshim që unë kërkoj falje publike. Nuk e kam besuar dhe menduar se kam para jo vetëm një Greqi, por edhe politikë dhe qeverinë", u

shpreh kreu i PDIU-së, i pyetur për deputetët që braktisën partinë. Sipas tij, votat e PDIU-së i ka marrë të gjitha mazhoranca dhe kjo për herë të parë nuk ishte një merkato apo "tregu çam", siç e cilësoi me shaka. "Ne kemi pasur bashkëpunim me PD dhe PS. Ka zëra që thonë do të dalim të vetëm në zgjedhje, e kemi kërkuar sistemim proporcional kombëtar, nëse do ishte kështu, ne do të kishim tanë 8 mandate", ldoi Shpëtim Idrizi. Shpëtim Idrizi



Kreu i PBDNJ, Vangjel Dules

partia e Vangjel Dules ikën. **TAKIMI** "Unë do takohem nesër (sot) me Bashën. Unë mendoj se për herë të parë ky vend duhet të ketë një të djathtë solide. Populli duhet të thotë në votime që unë nëse votoj për të djathtën, të votoj për më pak taksa etj., etj. PDIU ka qenë një parti e konsoliduar. Ju e dini që ne kemi fituar edhe bashki dhe do fillojmë një organizim brenda partisë dhe për ta bërë gati për sfidat elektorale. Ne vlerësojmë kontributin e të gjithëve në opozitën e bashkuar dhe nuk është problem se është edhe PBDNJ me opozitën. Ne po bëjmë një aleancë me PD dhe më pas do kërkojmë një marrëveshje me të gjithë aleatët", tha kreu i PDIU-së. "Në asnjë rast nuk kam konvencionuar interesa personale. Ne nuk kemi asnjë problem me kauzën e Vangjel Dules, siç është edhe çështja e Çamërisë. Ne e kemi konfliktin me qeverinë greke, e cila duhet t'i hapë rrugën çështjes së Çamërisë. I them Dules, mos u merakos se interesat e Greqisë i mbron kryeministri Edi Rama. Ne nuk e kemi problemin me Vangjel Dulen. Kudo që shkojmë ne, ata ikin. Se ç'kanë folur (Dule-Basha) se di, është problemi ynë", - tha Idrizi.

Vizita

KREU I PD-SË
Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, nisi dje një vizitë në Maqedoni. Gjatë kësaj vizite zoti Basha do të ketë takime me liderët e të gjithë spektrit politik shqiptar në Maqedoni. Temë kryesore e këtyre takimeve pritet të jetë referendumi për çështjen e emrit dhe anëtarësimi i Maqedonisë në NATO.

rizi tha se do të takohet sot me Lulzim Bashën, ndërsa nuk e ka problem se në ko-

alicionin e opozitës është edhe PBDNJ e Vangjel Dules. Sipas tij, kudo që shkon PDIU,



PD akuzon Ramën e Xhafajn: Kompania e vëllait të ministrit dhjetëfishoi të ardhurat

Kazinetë, Fuga: Qeveria, projekt të ri për të kufizuar industrinë e basteve

"Asnjë familjar i kryeministrit e ministrit me kompani bastesh"

Darina Tanushi

Cështja e lojërave të fatit përplasi dje opozitën e qeverinë. Deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj tha dje se, "kompania e bixhozit të vëllait të ministrit të Brendshëm dhjetëfishoi të ardhurat nga 1 milion euro, në 10 milionë euro". Ndërkohë që në emër të qeverisë shqiptare, drejtori i Komunikimit i Kryeministrit, Endri Fuga sqaroi se, "asnjë familjar i kryeministrit apo ministrit të Brendshëm nuk ka asnjë lidhje me kompanitë e basteve apo atyre që bëjnë monitorimin e basteve 'online', siç shpif Partia Demokratike". Fuga sqaroi se qeveria shqiptare është e angazhuar për të dhënë një zgjidhje përfundimtare edhe për industrinë e basteve, ku shumë shpejt do të jetë gati projekti i ri ligjor i kufizimit të fortë të tyre. "Partia Demokratike vazhdon avazin e vjetër dhe të dëshpëruar të baltosjes së përditshme. Prej dy ditësh akuzon në hava, pa as edhe një fakt të vetëm, vëllain e kryeministrit dhe atë të ministrit të Brendshëm, për favorizim të kompanive të basteve dhe lojërave të fatit", u shpreh Fuga. Në datë 31 dhjetor të këtij viti, duke mbajtur zotimin e dhënë dhe të sanksionuar në ligj si afati i fundit për kompanitë, sipas Fugës, "nuk do të ketë më asnjë kompani lojërash fati brenda territorit të qyteteve". "Nëse gjatë qeverisjes së PD-së ekzistonin 40 kompani të tilla dhe arkëtoheshin nga shteti 37 milionë dollarë, sot numri i kompanive është përgjysmuar dhe të ardhurat në buxhet nga aktiviteti i tyre janë pothuajse dyfishuar", theksoi ai. Po ashtu, Fuga theksoi se, "kompanitë për të cilat opozita baltos qeverinë kanë rinovuar licencat e tyre ose kanë marrë licencat të reja gjatë viteve kur në qeveri ishte Sali Berisha dhe Luzlim Basha". "Nga PD nuk presim dot asgjë tjetër. Por kemi të drejtë të presim që



Deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj



Drejtori i Komunikimit i Kryeministrit, Endri Fuga

më në fund mediet që i pasqyrojnë këto shpifje apo përgënjeshtime, të bëjnë mundësisht punën e tyre dhe të verifikojnë kush gënjën në këtë mes. Ndërkohë, kryeministri dhe qeveria do të vijnë në punimin më të gjithë vëmendjen për njerëzit, pa humbur kohë dhe energji në rrugën e vjetër të baltës, ku opozita zvarritet e përpiqet pa pushim të

zvarritë vetë Shqipërinë", tha Fuga. **OPOZITA** Ndërkohë, më herët dje, deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj tha se gjatë kësaj qeverisjeje numri i kompanive të licencuara për bastet u përgjendua në 3 duar. "Shqiptarët duhet të dinë se 1 nga 3 kompanitë më të fuqishme të basteve në Shqipëri zotërohet nga

Agron Xhafaj, vëllai i ministrit të Brendshëm, i dënuar në Itali për trafik ndërkombëtar droge dhe pjesëmarrje në krim të organizuar. Shqiptarët duhet ta dinë se disa nga pikat më të njohura të basteve që u zhvatin paratë shqiptarëve në mesin më shkatërrues për familjet janë të zotëruara nga kompania, prapa së cilës qëndron vëllai i ministrit të Brendshëm, tha Alibeaj. "I fshihur pas identitetit të dy anëtarëve të tjerë të bandës, të dënuar në të njëjtin proces në Itali, Agron Xhafaj ia ka dalë që menjëherë pas ardhjes në pushtet të të vëllait Fatmir Xhafaj, të zgjerojë aktivitetin e kompanisë së basteve me shtimin e 2176 pikave të reja në të gjithë Shqipërinë. Është kjo pasuri marramendëse që ndan me krimin e organizuar, e cila detyron Edi Ramën dhe Fatmir Xhafajin të refuzojnë vettingun e politikanëve", tha deputeti demokrat.

VENDIMI

Në datë 31 dhjetor të këtij viti, duke mbajtur zotimin e dhënë dhe të sanksionuar në ligj si afati i fundit për kompanitë, sipas drejtorit të Komunikimit në Kryeministri, Endri Fuga, "nuk do të ketë më asnjë kompani lojërash fati brenda territorit të qyteteve".



Panariti në Korçë: T'u jepen fermerëve paratë e premtuara

Deputeti i LSI-së së qarkut Korçë, Edmond Panariti, ka kërkuar nga qeveria që t'u japë paratë e premtuara për subvencione fermerëve. Deklaratat, Panariti i bëri gjatë një takimi me fermerët në njësinë administrative Dardhas të Pogradecit, ku ai shoqërohej gjithashtu dhe nga sekretari i përgjithshëm i LSI-së, Endrit Braimllari. Panariti tha se qeveria duhet të heqë dorë nga shpenzimet e saj marramendëse për dixhitalizimin dhe investimet joproduhëse dhe të mbajë fjalën e dhënë fermerëve për paratë e subvencioneve. "Ata para, të cilat tashmë ju po i shpenzoni pa kursim për dixhitalizim dhe investime joproduhëse, hidhni tek fshati, hidhni tek fermeri, në mënyrë që ai të jetë gjatë me nder, në mënyrë dinjitoze dhe të mos marrë arratinë sikundër e ka marrë tashmë drejt emigracionit, por t'i kthehet punës dhe prodhimit. Ky është mesazhi ynë i qartë. Mesazh që unë e bëj në emër të fermerëve, të cilët unë i kam takuar me dhjetëra e qindra këto ditë në lëvizjet që kam bërë dhe që ka qenë një mesazh i zëshëm. Në rast se ju nuk i mbështesni fermerët, ata nuk do të aplikojnë më. Nuk do të aplikojnë më, sepse nuk do t'ju besojnë më", tha deputeti i LSI-së dhe ish-ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti.

Fluturimi i parë me "Lasgushin", Rama iu uron udhë të mbarë studentëve të ekselencës

Berisha: Nga Rinasia nuk u nis avioni i "Air Albania", por i "Turkish Airline"

Kryeministri Edi Rama mori pjesë dje në nisjen e avionit të parë të "Air Albania" nga Rinasia, kompanisë së parë ajrore shqiptare, që mban ngjyrat e flamurit shqiptar dhe shqiptonjën dy krenare. Udhëtarët e parë që fluturuan me avionin e quajtur "Lasgushi", për nder të poetit të madh Lasgush Poradeci, ishin studentët dhe maturantët e ekselencës, të cilëve Rama iu uron rrugë të mbarë në këtë udhëtim drejt Stambollit. "Më vjen shumë mirë që këtë fluturim të parë të testit të 'Air Albania' e bëjnë studentët dhe maturantët e ekselencës. Është një fluturim simbolik, ndërkohë që gjatë



gjithë muajit do të jenë disa të tilla. Arsyetja pse na shkoi mendja tek ju është sepse ju jeni fytyra e ndritur e gjenëratës së vjetër dhe meritoni që të keni të gjithë vëmendjen dhe respektin, dhe njëkohësisht edhe një dhuratë simbolike për gjithë këni bërë dhe gjithë këni bënë", u shpreh Rama. Kjo paraqitje u ironizua dje nga opozita. Ish-

kryeministri Sali Berisha, por edhe deputetë të PD-së e LSI-së kanë denoncuar faktin se kjo nuk është kompania e parë shqiptare. Ndërsa publikon një dokument të shkëputur nga të dhënat "online" të aeroportit, Berisha shkruan se dje nga Rinasia nuk u nis asnjë avion i "Air Albania". Berisha akuzon kryeministrin Rama, të cilin në postimet e tij i drejtohet gjithnjë me togjalëshin "Kallam Dësh-taku", se po u shet shqiptarëve "Turkish Airline" për "Albanian Airline". Referuar fluturimit të "Air Albania", ish-kryeministri thotë se ai është një fluturim shtesë i "Turkish Airlines", me numër fluturimi TK 6888.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e Illojt 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;
 B. Pasuria nr. 26/ 320, e Illojt 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;
 ÇMIMI 78.976.000 LEKË për secilin pasuri; në Total 157.952.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë **26.09.2018**.
 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPËRFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILIMI SULA.
 ÇMIMI **6.800.000 LEKË**. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 01.10.2018.
 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Përmbareusi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Tretë për pasuritë e paluajshme si më poshtë;

- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, në vlerën **4756 000** (Katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.
 - Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, në vlerën **4756 000** (Katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.
 - Pasuria Nr. 21/111, Vol.-4, fq.-201, Z.K-1791, Illoj AVE me Sip.-500 m2, në vlerën **252 000** (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) Lekë.
 Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 03.10.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbareusit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069773 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, i ftuar të flasë në akademinë politike të rinjve të FRESSH u bëri thirrje atyre të krijojnë ëndrrën për të ardhmen, ndryshe do kenë "fatin e shokëve të Qemal Stafës". Duke folur për temën "Sfidat... si politikë", Majko tha në fjalën e tij: "Përdorimi i drogës në Shqipëri po mbështetet nga kultura e cila të tashmen nuk e konsideron qëllim. Ajo e konsideron të kaluarën dhe të tashmen si "mjete". Mjaft të rinj vetëm të ardhmen e kuptojnë si qëllim. Kjo

Ministri për Diasporën u flet të rinjve të FRESSH për sfidat në politikë

Majko: Krijoni ëndrrën, ndryshe përfundoni si shokët e Qemal Stafës

mënyrë jetese, e cila vetëm shpreson se do të jetojë po krijon pamjaftueshmërinë, varësinë dhe zbrastirësinë, e cila mban larg të rinjtë nga jeta aktive". "Ndarja mes gjeneratave sot në Shqipëri është më e madhe se në të kaluarën. Po shfaqet problemi i keqtrajtimet të moshës së tretë, duke i vlerësuar si

të padobishëm. Prindërit e moshuar po mbyllen në shtëpi pleqsh ose lihen të izoluar si provë e vështirësisë të brezit të ri në harmoninë me të vjetrit. Të rinjtë po rrethojnë të humbin kuptimin për natyrën. Çrregullimi ambiental po rrobëron kulturën e jetës me betonin e hirtë të qyteteve", u shpreh

Majko. "Miq, unë nuk jam pesimist. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, nuk do të merresha me politikë. Kur më futat të flisja për temën 'sfidat' u ndjeva në vështirësi. Kjo fjalë sot tek ne, 'tundron' midis asgjësë dhe gjithçkasë. Fondacioni juaj që organizon këtë aktivitet mban emrin 'Qemal Stafa'. Ai ishte



komunist. Por, Qemal Stafa kishte një veçanti. Ai përfaqësonte shpresë dhe ëndërr për të nesërmen, për brezin e tij nën okupacionin e vendit. Pa krijuar ëndrrën e kohës

sua mos tentoni seriozisht të merreni me politikë. Do ktheheni veç në 'burokratët' e saj. Do të keni fundin e shokëve të Qemal Stafës", u shpreh Majko.

Ambasadori i SHBA jep mesazhin e fundit: Rrugë e mbushur me konflikte, por na garanton liritë

Dita e Demokracisë, Meta: Të rinjtë të udhëheqin evropianizimin e vendit

Krasniqi: Ecuria e nivelit të demokracisë, zhgënjyese

Në ditën Ndërkombëtare të Demokracisë, Presidenti Ilir Meta u bëri thirrje djë të rinjve të udhëheqin proceset demokratike për evropianizimin e plotë të vendit. Presidenti deklaroi se demokracia duhet zhvilluar sipas standardeve më të avancuara dhe siç e meriton kombi ynë. Në mesazhin e tij, kreu i shtetit shprehet se, "demokracia nuk është dhënë një herë e përgjithmonë". "Demokracia nuk vjen si dhuratë dhe as qëndron si e tillë. Demokracia duhet ruajtur, duhet mbrojtur, duhet zhvilluar sipas standardeve më të avancuara dhe siç e meriton një komb si i yni, që ka vuajtur shumë nga mungesa e saj", thekson Meta. Presidenti shton se, "rinia e sotme, me shpirtin e lirë, energjinë, guximin e kurajën e saj, të udhëheqë proceset demokratike për evropianizimin e plotë të vendit". Po në këtë ditë, ambasadori i SHBA në Tiranë, Donald Lu deklaroi se, "demokracia është diçka që na bashkon të gjithëve ne, amerikanë dhe shqiptarë". Në një postim në faqen zyrtare të ambasadës amerikane në "Facebook", Lu shprehet se demokracia arrihet me sakrificë. Ai shton se është një rrugë e mbushur me përplasje e polemika, por ambasadori thekson se ia vlen ta arrish demokracinë, pasi na garanton liritë tona themelore. "Sot është Dita Ndërkombëtare e Demokracisë. Çfarë do të thotë demokraci për ju? Demokracia është diçka që na bashkon të gjithë ne, amerikanë dhe shqiptarë. Është e komplikuar. Dhe shpesh është e mbushur me konflikte dhe polemika, por në fund,



Ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu dhe presidenti Ilir Meta

demokracia na garanton liritë që i konsiderojmë kaq të vyerë", shkruhet në faqen e ambasadës së SHBA-ve. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2007 ka shpallur se data 15 shtator duhet të festohet çdo vit nga e gjithë bota, si Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, me qëllim për të theksuar nevojën e vazhdueshme për të promovimin e demokratizimit të shoqërive të ndryshme anë e mbanë botës, si edhe për të theksuar rëndësinë e zhvillimit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të çdo individit kudo. Me miratimin e rezultës, Asambleja e Përgjithshme ritheksoi se, "ndërsa demokracitë ndajnë shumë

gjëra të përbashkëta, nuk ekziston asnjë model vetëm i demokracisë (për të gjithë) dhe se demokracia nuk i përket një vendi ose një rajoni, por demokracia është një vlerë universale, e bazuar në shprehjen e lirë të popujve për të vendosur vetë sistemet e tyre politike, ekonomike, shoqërore e kulturore, si edhe për të vendosur lirisht pjesëmarrjen e tyre në të gjitha aspektet e jetës". Ndërkohë, drejtori i Institutit të Studimeve Politike, Afrim Krasniqi, në një shënim të tij djë, vë në dukje se Shqipëria mbetet peng i një elite konsensusuale korruptive. "Tabela e ecurisë së nivelit të demokracisë është zhgënjyese: në vitet 2000 kishte korrupsion, por kish-

te më shumë demokraci brenda partive politike; kishte abuzim me pushtetin, por kishte më shumë hapësirë konkurruese. Sot vijon trendi negativ i kufizimit të demokracisë. Dikur adhurim modelin Thaçer apo Regan, sot adhurim modelin Erdogan e Salvini. Krijuan parti për të jetësuar pluralizmin dhe sot ato janë shndërruar në bunkerë strehues të 2-3-4-5 emrave riciklues në pushtet e tranzicionit. Krijuan sistem votimi për të pasur konkurrencë dhe sot jemi në kohën e votimit formal, ku kritiku më periferik i ndërpritet karriera politike për një vendim të vetëm të ndryshëm nga shefi", analizoni Krasniqi për Shqipërinë.

Ambasadori bullgar: Mbështetje integritetit evropian të Shqipërisë

Bullgaria, duke njohur vlerat historike e kulturore, si dhe zhvillimin e dukshëm ekonomik që ka pësuar Shqipëria do të ndihmonte që shumë shpejt edhe ajo të ishte pjesë e familjes europiane". Kështu u shpreh ambasadori i Bullgarisë në Tiranë, Momtchil Stoyanov Raytchevski gjatë një vizite në Berat, ku u prit nga dy nënkryetarët e bashkisë Çlirim Brisku dhe Afize Skëndo. Ambasadori bullgar u shpreh se duke qenë se ishte historiani, i njëjti mirë vlerat historike e kulturore të këtij qyteti, prandaj do të dëshironte t'i forconte edhe më tej këto marrëdhënie duke u dhënë atyre një impuls të ri në çdo fushë; arsimit, kulturës, turizmit, ekonomisë etj. Më konkretisht, në fushën e arsimit, qeveria bullgare ofronte bursa të plota në Universitetin e Sofjes për komunitetin bullgar që jeton në Shqipëri, por edhe për cilindo tjetër që plotëson disa nga kriteret e kërkuara. Nënkyetari Brisku bëri një prezantim të shkurtër të Beratit, të trashëgimisë së tij kulturore dhe historike, si dhe të resurseve që ai ofronte për vizitorët vendës dhe të huaj, citon ATSH. Ai gjithashtu theksoi marrëdhëniet e mira të bashkëpunimit që Bashkia e Beratit ka pasur me disa nga qytetet bullgare, sidomos me Bashkinë Llovech, me të cilën qyteti i Beratit është binjakëzuar.

SHPLLJE ANKANDI
Date 18.09.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzansës Halilhe Shefqet Burhani:
"Aparamenti banim + Trusli" me sipërfaqe 62 m2, me nr. pasurie 14/301, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistër hipotekar nr. 2561 date 07.10.1994, adresa: Laga "15 Shtator", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Topelino.
Cmimi lilestar i ankandit të dytë është në shumën 896 000 (tetëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

SHPLLJE ANKANDI
Date 21.09.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajshme të dorëzansës Petrit Sini Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:
"Aparamenti" me sipërfaqe 54 m2, me nr. pasurie: 11/26-1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Laga "Gjokë Doci", Peshkopi, Dibër.
Cmimi lilestar i ankandit të dytë është në shumën 1 120 000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përmbarimore "Best 2018"
SHPLLJE ANKANDI
Më datë 16 tetor 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shifren a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol.52, fq.1, ZK.8603, me cmim lilestar 33075000 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol.52, fq.28, me cmim lilestar 251566000 lek
Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka dërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIJ5 J97201218L)
Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Reduktohen pagesat e shërbimit përbarimor privat, tabela me tarifaf fikse

Ekzekutimi i vendimeve, tarifaf e reja të përbarimit

Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Financave vendosin ulje të çmimeve

Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave kanë miratuar tarifaf e reja për përbarimin privat. Përmes një udhëzimi që mban firmën e dy ministrave është vendosur ulja e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat. Krahasuar me vendimin e mëparshëm të qershorit 2017, tarifaf ulen për të gjitha vlerat e detyrimit. Nëse më parë tarifaf fikse niste nga 15 mijë lekë, tashmë ajo nis nga 6 mijë lekë dhe rritet në bazë të vlerës së detyrimit. Ndërkohë, zbritje ka edhe për tarifaf që aplikohen si përqindje, ku do të aplikohet një maksimum prej 2.5 milionë lekësh, krahasuar me maksimumin prej 15 milionë lekësh më parë. Referuar tabelës së re të tarifave, mësohet se vlera e tarifës fikse të shërbimit përbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar si kthim shume dhe/ose pagim detyrimi, përlllogarit në këtë mënyrë: një debitor, të cilit i mblihdhet shuma e borxhit nga 1 - 100,000 lekë me forcë, duhet të paguajë si tarifë për përbarimin 15,000 lekë. Për një shumë borxhi nga 100,001 - 300,000 përbaruesit mbajnë 22,000 lekë; për shumën nga 300,001 - 500,000 lekë mbajnë 22,000 lekë; për shumën 500,001 - 2,000,000 lekë mbajnë 10 %; për 2,000,001 - 5,000,000 lekë mbajnë 8 %, e kështu me radhë tarifaf vjen duke u reduktuar në proporcion me rritjen e shumës së borxhit që i mblihdhet debitorit, duke arritur në 3%, por jo më shumë se 15 milionë për një shumë prej mbi 90,000,000 lekë. Ndërkohë, me udhëzimin e ri që ka hyrë në fuqi ditën e djeshme me botimin e Fletoren Zyrtare, ministri Ahmetaj dhe Gjonaj kanë ndjekur një tjetër skemë, duke i ulur ndjeshëm këto tarifaf. Kështu, për mbledhjen e një shume borxhi prej 1 - 10,000 lekësh, përbaruesi do të përfitojë vetëm 6,000 lekë. Për një borxh prej 10,001 - 20,000 lekësh do të mbajë 7,000 lekë; për një borxh prej 20,001 - 30,000 lekësh do të mbajë 8,000 lekë e kështu me radhë rritja e takës do të vijë në proporcion me shumën e mbledhur, për të arritur në shifrën më të lartë, ku për mbi 90,000,000 lekë detyrim të mbledhur, përbaruesi mban 1.1% të vlerës, që dot thotë minimumi 1,485,000 lekë, maksimumi 2,500,000 lekë. Ndërkohë që vlera e tarifës fikse të shërbimit përbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar dhe të pavlerësueshëm, përlllogarit në varësi të objektit të ekzekutimit. Për reklamimin e një sendi të luajshëm ose të paluajshëm,

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifaf fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1%
	Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifaf fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000
150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

TARIFAF

Krahasuar me vendimin e mëparshëm të qershorit 2017, tarifaf ulen për të gjitha vlerat e detyrimit. Nëse më parë tarifaf fikse niste nga 15 mijë lekë, tashmë ajo nis nga 6 mijë lekë dhe rritet në bazë të vlerës së detyrimit. Ndërkohë, zbritje ka edhe për tarifaf që aplikohen si përqindje, ku do të aplikohet një maksimum prej 2.5 milionë lekësh, krahasuar me maksimumin prej 15 milionë lekësh më parë.

aktualisht vlera e tarifës fikse përlllogarit në masën e 2 pagave bazë minimale mujore. Për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajshëm, vlera e tarifës fikse përlllogarit në masën e 5 pagave bazë mini-

male mujore. Për vënien në posedim të sendit të luajshëm, vlera e tarifës fikse përlllogarit në masën e 3 pagave bazë minimale mujore kur sendi nuk ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes. Për marrjen e fëmijës dhe le-

jimin e së drejtës së vizitës, vlera e tarifës fikse përlllogarit në masën e 1 pagë bazë minimale mujore. Për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand, vlera e tarifës fikse përlllogarit në masën e 2 pagave bazë minimale mu-

jore. Për zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pavlerësueshëm, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar, vlera e tarifës fikse përlllogarit në masën e 3 pagave bazë mini-

male mujore. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përbarimor, kur titulli ekzekutiv është vendim i gjykatës për sigurimin e padisë varion nga gjysmë page bazë minimale mujore-7 paga bazë minimale mujore.

Informim intensiv i tatimpaguesit

DRT e Fierit, 43,238 kontakte me tatimpaguesit dhe individë

Drejtoria rajonale Tati more e Fierit vlerësohet si një nga drejtoritë, ku shërbimi i tatimpaguesve ka pasur një performancë pozitive gjatë këtij viti. Sipas njoftimit për mediat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rezulton se vetëm gjatë periudhës janar-gusht 2018 janë realizuar përmes të gjitha rrugëve të komunikimit direktë dhe elektronike 43,238 kontakte me tatimpaguesit dhe individë. Përmes platformave 'online' të komunikimit është bërë e mundur marrja e shpejtë e informacionit për të gjitha çështjet e ngritura, duke reduktuar në këtë mënyrë kontaktet e drejt-përdrejta me administratën tatimore. Gjithash-tu, në kuadër të fushatës së informimit për përfshirjen në skemën e TVSH-së të biznesit të vogël, referuar të dhënave të Drejtorisë rajonale Tatimore Fier, vetëm



në Këndin e Asistencës u informuan mbi procedurat 915 tatimpagues, ndërsa u asistuan në terren 940 tatimpagues të vegjël. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, aktualisht po zbatohet një tjetër fushatë informimi dhe edukimi në të gjitha drejtoritë rajonale të tatimore. Janë 11 kategori të biznesit, ku përfshihen per-

sona juridikë, fizikë, ambulante, individë dhe fermerë që po njihen me të drejtat dhe detyrimet tatimore përmes broshurave dhe videove, kjo në kuadër të Platformës së Informimit, një projekt që po zbatohet me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Broshurat përmbajnë informacion të detajuar për të gjitha hapat e ciklit të jetës së një biznesi, nga regjistrimi, deklarimi, pagesat e detyrimeve, si dhe të drejtat e detyrimit e tjera lidhur me administratën tatimore. Informimi dhe edukimi i tatimpaguesve me korrektësi vijon të mbetet një ndër prioritetet e administratës Tatimore. Lidhur me këtë çësje, në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore janë të ngritura dhe funksionojnë zyrat e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Këndi i Asistencës i dedikuar ndaj biznesit të vogël dhe Këndi i Bashkëqeverisjes.



Shpenzimet për paga u rritën në shumicën e sektorëve

Bizneset rritën shpenzimet për fondin e pagave në tremujorin e dytë të vitit në shumicën e sektorëve ekonomikë, çka dëshmon vijimësinë e ecurisë pozitive të tregut të punës. Rritja e fondit të pagave përgjithësisht është më e lartë se rritja e numrit të të punësuarve, çka nënkupton një rritje të pagës mesatare. Ecurinë më pozitive në kuptimin e rritjes së fondit të pagave e raportuan industria përpunuese dhe hoteleria. Në industrinë përpunuese, fondi i pagave u rrit me 18.7%, duke iu bashkangitur edhe treguesve pozitivë të shitjeve dhe punësimit për të njëjtin tremujor. Edhe industria nxjerrëse ndodhet në një cikël pozitiv, falë çmimeve të përmirësuar të lëndëve të para. Indeksi i fondit të pagave në këtë degë u rrit me 8.1%, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Mesatarisht, fondi i pagave në sektorin e industrisë u rrit me 15.9%, me kontributin të konsiderueshëm edhe të sektorit energjetik. Edhe ndërtimi regjistroi rritje të fondit të pagave me 9%, megjithëse në tremujorin e dytë sektori raportoi rënie vjetore të shitjeve. Për sa u takon shërbimeve, ecurinë më pozitive e shfaqën degët e lidhura me turizmin dhe sidomos hoteleria, ku fondi i pagave u rrit me 15.5%. Edhe dega me peshën kryesore në shërbime, tregtia, raportoi rritje vjetore të fondit të pagave me 6.6%.

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, policia italiane ka sekuestruar një skaf me 1.7 tonë kanabis, ndërsa kanë përfunduar në pranga dy shqiptarë. Sipas "Guardia di Finanzia"-s, operacioni i sekuestrimit të gomones me drogë është ekzekutuar nga reparti ajror detar i financës italiane të rajonit të Pulias, Molises e Abruzos, me mbështetjen e mjeteve ajrore të operacionit "Themis 2018" të asgjesisë europiane "Frontex" dhe nën drejtimin e Drejtorisë Operative të Financës italiane në Praticca di Mare të Romës. Mësohet se gjatë natës, rojet bregdetare italiane në provincën e Foxhias kanë pikasur në ujërat ndërkombëtare një gomone që lundronte me shpejtësi të madhe drejt brigjeve italiane. Në bordin e mjetit ishin të duk-

Policia shqiptare: Mjeti me drogë s'u nis nga Shqipëria

Sekuestrohet skafi me 1.7 tonë kanabis në Itali, përfundojnë në pranga dy shqiptarë

PROKURORI I ANTIMAFIAS

"Mafia nigeriane dhe ajo shqiptare janë ndër më të pranishmet në territorin italian, mbi të cilët hetojmë me imtësi". Deklarata vjen nga Prokurori i Antimafias Italiane, Federico Cafiero de Raho në komunën Casal di Principe, në ceremoninë e dhënies së titullit 'Qytetar Nderi'. Ndërkohë, ai ka pohuar se, "mafia shqiptare vepron në pozitë të barabartë me klanet mafioze italiane, me të cilat bën biznes për të administruar së bashku trafiqet ilegale".

shme pakot me ngarkesë të dyshimtë. Sakaq, mjetet lundruese të forcave italiane janë vënë në ndjekje të gomones, por skafistët nuk i janë përgjigjur urdhrat të

ndalimit, por janë përpjekur të largohen duke shtuar shpejtësinë dhe duke hedhur në ujë disa prej pakove që kishin në bord. Pas një ndjekjeje të shkurtër, është bërë

i mundur ndalimi dhe sekuestrimi i gomones në ujërat pranë provincës së Foxhias. Sipas "Guardia di Finanzia"-s, kjo sasi drogë, nëse shitej në treg me doza të vogla do të gjeneronte rreth 15 milionë euro. Pas publikimit të lajmit nga mediat italiane dhe dyshimeve se skafi me drogë ishte nisur nga Shqipëria, ka reaguar Policia e Shtetit, e cila ka dhënë detaje për operacionin.

POLICIA

Sipas policisë sonë, skafi me drogë nuk është nisur nga Shqipëria dhe sinjalizimin e parë e kanë dhënë



Droga e sekuestruar në Itali

autoritetet kroate. "Gomonia është sinjalizuar fillimisht nga policia kroate, si e dyshuar në dalje nga ujërat e tyre territoriale. Gomonia është pikasur nga 'Guardia di Finanzia' në zonën e Viestes në të njëjtin drejtim të ujërave kroate. Në bordin e mjetit janë kapur 2

shtetas shqiptarë, A.L. 38 vjeç dhe A.A. 36 vjeç, si dhe u sekuestrua rreth 1.700 kg kanabis. Mjeti detar sipas hetimeve të deritanishme nga policitë e vendeve partnere, nuk është nisur nga brigjet shqiptare", deklaroi ndër të tjera Policia e Shtetit.

Ja si u shpëtoi tri atentateve 37-vjeçari Arlind Lulushi

Arbër Sulo

SARANDË

Truproja e një diskoje është plagosur në orët e para të mëngjesit të së premtes në Sarandë, ndërsa policia ka zbardhur ngjarjen dhe ka shpallur në kërkim autorin. Gjithashtu, blutë kanë arrestuar kolegun e truprojes së plagosur për moskallëzim krimi. Sipas burimeve zyrtare nga policia, ngjarja ndodhi rreth orës 02:32, në lagjen nr.1 Sarandë, në ambientet e jashtme të një lokal-disko, ku 37-vjeçari që punonte si "bodyguard", (truprojë) është qëlluar me armë zjarri nga një shtetas tjetër, i cili duke përfutur nga errësira është larguar menjëherë me një automjet nga vendi i ngjarjes. Të njëjtat burime pohuan se falë veprimeve hetimore intensive janë identifikuar autorët e plagosjes së Arlind Lulushit, duke arrestuar një prej tyre si dhe shpallur në kërkim tjetrin. Në pranga ka përfunduar Joan Buli, 36 vjeç, lindur në Tiranë, me banim të përkohshëm në Sarandë, punonjës në objektin në fjalë (truprojë), i cili akuzohet për "Moskallëzim krimi". Ndërkaq, në lidhje me plagosjen e 37-vjeçarit nga Vlora është shpallur në kërkim shtetasi me iniciale D.M., 31 vjeç, banues në Sarandë, i cili pohohet të jetë autori i krimit. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta. Mësohet se Lulushi ndodhet i shtruar në Spitalin e Traumës Tiranë për mjekim më të specializuar, jashtë rrethit për jetën. Materialet në referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë për veprat penale "Moskallëzimi i krimit", "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Mbahytja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit".

Plagoset truproja e diskos në Sarandë, shpallet në kërkim autori

Arrestohet kolegu Joan Buli për moskallëzim krimi



37-vjeçari i plagosur, Arlind Lulushi

KUSH ËSHTË TRUPROJA

Arlind Lulushi është një emër i njohur për policinë, pasi në vitin 2011 ka qenë i arrestuar për lëndë narkotike. Ai u ka mbijetuar edhe dy atentateve të tjera në të kaluarën. Në dhjetor të vitit

2016, Lulushi i shpëtoi atentatit të parë, fatmirësisht pa asnjë lëndim. Më 9 shkurt 2017, Lulushi u bë sërish atentat me armë zjarri. Ai ndodhej në vendin e punës kur u qëllua në drejtim të tij me automatik, e për pasojë mbeti i plagosur në këmbë. I

riu për t'i shpëtuar vrasjes është larguar me vrap në rrugën kryesore, ndonëse i plagosur, duke rënë më pas pa ndjenja. Ka qenë pikërisht një mjet i rastit që e ka çuar me urgjencë në spital. Në atë kohë policia nisi hetimet për atentatin në disa pista, që

nga hakmarrja e mundshme dhe tek një konflikti i mëparshëm që ka pasur riu me disa persona, që i bënë edhe atentatin para pak muajsh. Kjo pasi emri i Arlind Lulushit lidhet edhe me një ngjarje të rëndë të vitit 2015 në Vlorë, ku dy të rinj, një djalë dhe një vajzë mbetën të vrarë pas të shtënave me armë. Ngjarja e rëndë ndodhi në 2 janar të vitit 2015. Në këtë ngjarjeje, 21-vjeçarja Paola Bisha dhe kushëriri i saj Parid Velaj, 28 vjeç, u ekzekutuan me armë zjarri nga Ervis Lulushi, pasi ky i fundit i kishte kërkuar vajzës që të rilidheshin bashkë. Në atë kohë, policia shoqëroi Arlind Lulushin, i cili u akuzua si bashkëpunëtor i kushëririt të tij Ervis Lulushi. Por, Arlindi u lirua për mungesë provash.

VLORE

Operacioni "Maskimi", sekuestrohen armë, tritol dhe drogë

Policia e Vlorës ka finalizuar një operacion të premtur ku ka sekuestruar armë zjarri, municion luftarak, tritol, kapsolla, granatë ofensive si dhe sasi lëndë narkotike. Në zbatim të planit operacional për kapjen e personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të atyre që ushtrjnë veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve, blutë e Vlorës me mbështetjen e Delta Forcë dhe FNSH-së Pier zhvilluan operacionin e koduar "Maskimi". Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit Gjergji Petani, në lagjen "15 Tetori", Vlorë, konkretisht në magazinën në katin e parë të banesës, policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një pistoletë e llojit "Zastava" si dhe 161 fishekë; 4 kallëpe tritol, si dhe 5 ndezës detonatorë për tritol; një granatë ofensive si dhe 47 fishekë si dhe rreth 2 kg kanabis.

TIRANË - Për të dytën herë, gjykata e Tiranës i jep edhe tre muaj kohë prokurorisë për hetimin e çështjes së privatizimit në 2009-ën të OST tek çekët e CEZ. Zgjatja e afatit është miratuar nga gjykatësi Lazar Sallaku pas kërkesës së bërë nga organi i akuzës, i cili mbetet në pritje të dëshmisë së Nuel Kalajt, i konsideruar si njeriu kyç dhe që ka dijeni për rrethanat e çështjes. Por, pavarësisht

Dosja "CEZ", gjykata e Tiranës shtyn afatin e hetimeve edhe me tre muaj

se letërporosia drejt Kosovës për pyetjen e biznesmenit ka gjashtë muaj që ka marrë rrugë, ende autoritetet shqiptare nuk kanë informacion nëse ai i ka dhënë shpjegime për llogaritë e çështjes. Socialistët e akuzojnë Kalajin se ka luajtur rolin e sekserit në procesin e priva-

tizimit, nga e cila sipas tyre, shtetit i është shkaktuar një dëm mbi 400 milionë dollarë, e dëshmia e tij konsiderohet si provë tejtejet e rëndësishme për t'i dhënë zgjidhje çështjes. Nëse përgjigjja e letërporosisë nuk mbërrin brenda fundit të tetorit 2018, prokurorët janë të detyruar

të kërkojnë sërish shtyrje të afatit, në të kundërt duhet të konkludojnë për dosjen me të dhënat e administruar deri më tani. Gjasat janë që hetimet të zvarriten jashtë çdo afati, nisur kjo nga fakti se shumë dosje të nxehta kanë mbetur peng i letërporosisë.

Hetimet ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri mbeten të hapura, për shkak se priten përgjigjet e dy letërporosive, njëra për të cilave nga Mali i Zi. Më herët Krimet e Rënda pezulluan dosjen për Arbër Çekajn pas dyshimeve se tentoi të trafikonte 93 kg kokainë nga Ekuadori. Autoritetet e vendit të Amerikës Latine nuk iu përgjigjën asnjëherë drejtësisë shqiptare. **kl.la**

77-vjeçari i plagosur: Nuk i njoh Laert Haxhiun e Orges Bilbilin, kërkohj drejtësi!

Klodiana Lala

TIRANË

Operacioni i RENEA-s në Lushnje, Haxhi Lika: Po vishja pantallonat kur u qëllua me plumb në kokë

"Kam armë në banesë, por nuk e kam prekur me dorë"

Isha në gjumë kur dëgova zhurmë jashtë banesës. U zgjova dhe isha duke veshur pantallonat në drejtim me dritaren kur u qëllua nga policia. Nuk e di pse më qëlluan, ndaj kërkohj drejtësi". Kështu u shpreh dje Haxhi Lika nga fshati Remas i Lushnjës, i cili u plagos dy ditë më parë me plumb në kokë gjatë operacionit të zhvilluar nga Policia e Shtetit, RENEA dhe FNSH. I tronditur, 77-vjeçari që ndodhet i shtruar në Spitalin e Traumës në Tiranë pranoi se kishte armë në banesë, ndërsa tha se nuk e ka prekur me dorë. Ndërkaq, mjekët e këtij spitali bëjnë me dije se i moshuari është në gjendje stabil dhe po trajtohet për plagën në kokë. Tashmë, ai ka kaluar në pavion. Në lidhje me ngjarjen e ndodhur në Remas ka reaguar edhe bashkëshortja e të plagosurit, si dhe dy djemtë e tyre që u shoqëruan nga policia. Ata akuzuan policinë për plagosjen e 77-vjeçarit, që sipas tyre ishte duke fjetur kur u qëllua, ndërsa policia deklaroi zyrtarisht se i moshuari u plagos në rrethana të paqarta. "Grilat ishin ngritur, kur burri u godit me plumb. Unë isha afër tij dhe nuk më dëmtoi. Filluam të bërtisim, e nuk u mor vesh çfarë u bë. Nuk ishim nga ata që ishin grabitqarë dhe u hodhëm atje siç janë kapur të tjerët. I kemi djemtë në punën tonë", u shpreh e moshuara, teksa nuk i mbante dot lotët.

Ndërkohë, vetë Haxhi Lika, në një intervistë për "News 24" sqaroi me detaje ngjarjen. Ai tha se nuk kanë pasur asnjëherë probleme me policinë dhe se nuk i njeht dy të shumëkërkuarit Laert Haxhiun dhe Orges Bilbilin, për të cilët u deklarua nga blutë se dyshohej që fshiheshin në banesën e familjes Lika.

Zoti Haxhi, mund të më shpjegosh çfarë ndodhi mëngjesin e së premtes në shtëpinë tuaj?
Dëgjova një zhurmë, atje ishte policia. Unë isha duke veshur pantallonat drejt dritares kur më qëlloi policia.

Keni armë ju zoti Haxhi?
Po, kam një armë.

E keni prekur me dorë ditën e djeshme, e keni kapur me dorë?
Jo, s'e kam kapur.

Pse mendoni se e rrethoi policia shtëpinë tuaj?
Nuk e dimë, erdhën dje (të premten) e na shqetësuan.

Keni pasur probleme ndonjëherë me policinë?
Jo, asnjëherë.

I njëjti shtetasi Orges Bilbili dhe Laert Haxhiu?
Jo, nuk e njoh asnjërin nga ata. Nuk i njoh.

A keni ndonjë apel për shtetin? Çfarë kërkoni nga drejtësia shqiptare?
Unë dua drejtësi, pse më qëlloi policia.



Haxhi Lika duke folur për "News 24"



Bashkëshortja e 77-vjeçarit të plagosur

DËSHMIA E BASHKËSHORTES SË TË PLAGOSURIT
Bashkëshortja e Haxhi Likës nuk i mbante dot lotët ndërsa foli për ngjarjen e dy ditëve ditë më parë, kur policia mësyu në banesën e tyre dhe shoqëroi dy djemtë pas dyshimeve se aty fshiheshin dy persona të kërkuar nga shteti. "Grilat ishin ngritur, kur burri u godit me plumb. Unë isha afër tij dhe nuk më dëmtoi. Filluam të bërtisim e nuk u mor vesh çfarë u bë. Nuk ishim nga ata që ishin grabitqarë dhe u hodhëm atje, siç janë kapur të tjerët. I kemi djemtë në punën tonë", u shpreh e moshuara.

DËSHMIA E MBESËS SË 77-VJEÇARIT

"Unë dua nga shteti të dalin fajtorët para drejtësisë. Të dalin ata që kanë terrorizuar një lagje të tërë. Janë rrahur burra nga 50-60 vjeç. Haxhiu është 77 vjeç që është goditur. Të gjenden fajtorët kush i ka çuar atje dhe arsyen, kur s'ka asnjë lidhje me këta kriminelë. Të dalin para drejtësisë, kaq kërkohj. Nuk kemi punë as me politikë, as me asgjë. Duam fajtorët! deklaroi dje për "News 24" mbesa e të plagosurit Haxhi Lika.

"Po luajmë mendsh, na akuzojnë se mbajmë kriminelë në shtëpi"

Martin Lika: U zgjuam nga të bërtiturat e policëve, ja si ma qëlluan babain para syve



unë, më qëlluan babanë. Në atë moment unë kam lajthitur. Nuk dija çfarë të bëja. Pastaj dëgjova thirrjen: RENEA-Policia, RENEA-Policia. **Dolët jashtë?**
Jo, nuk dola jashtë, pasi mendoja se ata po ndiqnin ndonjë kriminel dhe kisha frikë. U ngjita lart dhe mora telefonin. Mora byazerin në telefon dhe i thashë hajde se kanë vrarë babanë. Pastaj dola jashtë dhe i kam bërtitur policisë: Hajdeni shpejt se më kanë vrarë babanë dhe merreni. Pastaj u dorëzova atje. Më kapën, më lidhën dhe më kanë lënë të mbështetur pas murit.

Babain kush e transportoi në spital?

Ata vetë me ambulancë. Ndërsa unë i pyesja vazhdimisht si është babai, ku është babai. Ata më thanë është shumë mirë babai.

U shpjegoi policia përse kishte ardhur në shtëpinë tuaj?

Jo. Në asnjë mënyrë, ndonëse unë i pyesja çfarë kemi bërë. U thosha më lini vetëm të shoqëroj babanë. Nuk kemi bërë gjë. Por ata më thanë qepe gojën, rri aty se ta ngjeshëm.

A mbani armë në shtëpinë tuaj?

Ka një armë, një çifte teke. E ka babai me leje. Unë një vete. Di që ajo ka tri vite pa fishekë, i është prishur dhe gjilpëra. Unë tani dua të di të drejtën, pse policia na terrorizoi në atë orë.

Zyrtarisht Policia e Shtetit thotë se ishte në ndjekje të dy personave të kërkuar, Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili. A keni ju njohje me këta persona?

Në asnjë mënyrë, as i njoh se kush janë. Në jemi

një familje që shikojmë punën tonë. Atyre as që u kemi dëgjuar emrin. Në shtëpinë tonë, gjallë në botë.

A keni pasur ndonjëherë probleme të mëparshme me policinë?

Asnjëherë. Jam 50 vjeç sot dhe nuk kemi pasur asnjëherë probleme me policinë, të gjithë si familje. Ta verifikojnë se çfarë familje jemi. Kush është babai im dhe ne dy vëllezërit. Ta verifikojnë. Ne duam ta dimë pse e kanë bërë atë gjë. Ata persona s'i njoh fare, s'e di ku janë. Kjo është të nderbesh, të luash mendsh. Pse na akuzojnë kot. Shtëpia ime të mbajë dy persona siç thonë ata që paskan vrarë e paskan prerë, kriminelë, është t'ia vësh plumbin, të vrasësh vetën. Në nuk jemi familje e tillë. Të pyesin gjithë fshatin se kush jemi ne.

Përse mendoni se ka ndodhur kjo? Përse është rrethuar pikërisht shtëpia juaj?

Atë nuk e di. Ata ta faktotojë policia. Unë këtë dua të di.

Albert Lika: Shkova të shikoja babain e plagosur, policia më dhunoi

Djali tjetër i familjes Lika, Alberti u shpreh dje se në shtëpinë e tij nuk është bërë kontroll. "Në lagje, po. Janë kontrolluar 5-6 banesa. Unë për veten time shkova direkt tek prindërit, pasi më mori vël-lai në telefon. Vajta direkt tek babai, ndërsa policia ishte jashtë shtëpisë së byazerit. Unë u thashë po vete njëherë te babai se më thanë se është vrarë dhe pastaj do paraqitem tek ju. Isha pa asnjë gjë në dorë. Pa asnjë lloj synimi. Ata më thanë mos hyr brenda, hajde me neve. Policët më dhunuan, më hodhën syzet në tokë, pasi shkova pa lejen e tyre të shtëpia e babait për ta parë. Më pas na shoqëruan mua dhe vël-lain në komisarjat. Atje na pyetën a kemi qenë të dënuar ndonjëherë apo jo dhe a kemi marrëdhënie me ata që kërkonin. Unë u thashë jo. As kemi marrëdhënie, as i kemi strehuar, as i njohim fare", u shpreh Alberti Lika, i cili u lirua së bashku me të vëllain pasi u morën në pyetje.

Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit i jep të drejtë shtetit shqiptar

HEC i Kalivaçit, Becchetti do paguajë 7 mln euro kompensim

Dëmshpërblim për mosndërtimin e hidrocentralit

Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka vendosur të rrëzojë padinë e kompanisë "Hydro SRL" të biznesmenit Francesco Becchetti ndaj Shqipërisë për hidrocentralin të Kalivaçit. Në vendimin e saj, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka vendosur që kompania e biznesmenit italian t'i paguajë 7 milionë euro si dëmshpërblim shtetit shqiptar për mosndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit.

Kalvari i gjyqve mes kompanisë "Hydro SRL" dhe shtetit shqiptar nisi prej vitit 2014, kur biznesmeni italian Francesco Becchetti paditi Shqipërinë në Gjykatën e Arbitrazhit, duke kërkuar zgjidhjen e koncesionit të Kalivaçit dhe 137.3 milionë euro dëmshpërblim. Në argumentin e tij, Becchetti pretendonte se ishte shteti shqiptar, ai që e kishte penguar ndërtimin e hidrocentralit. Republika Shqipëria paraqiti kundërpadi në këtë proces ku pretendoi se, pavarësisht nga mirëbesimi dhe vullneti i mirë që ka karakterizuar gjithmonë Shqipërinë në lidhje me zbatimin e këtij koncesioni, paditësi ka qenë në shkelje dhe mospërbushje të kontratës së koncesionit, për fajin e tij, duke i shkaktuar në këtë mënyrë



Biznesmeni Francesco Becchetti

një dëm prej 158,000,000.00 euro (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë euro). Krahas pagesës së këtij dëmi, Shqipëria kërkoj edhe pagesën e ka-

matëvonesave për mospërbushjen e kontratës deri në vlerën prej 12,900,000.00 euro (dymbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë euro) si edhe

të kostove ligjore dhe të procesit të arbitrazhit.

Në janar të këtij viti, trupa e gjykimin vendosi që të rrëzojë të gjithë pretendimet e paditësit, duke e ngarkuar këtë të fundit me faj për mospërbushjen e kontratës dhe me pagesën e kamatëvonesave deri në vlerën e cituar më lart dhe të ta gjithë kostove ligjore dhe të procesit të arbitrazhit të pësuara nga i paditur, në një vlerë prej rreth 1,258,642.00 euro (një milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e dy euro). Ndërsa tha se në një vendim të dytë do të vendoste vlerën e dëmshpërblimit që paditësi do të duhet t'i paguajë Shqipërisë për mospërbushjen e kontratës së koncesionit, vendim i cili u mor vetëm pak ditë më parë.

PADIA E SHQIPERISE

Shqipëria paraqiti kundërpadi në këtë proces, ku pretendoi se paditësi ka qenë në shkelje dhe mospërbushje të kontratës së koncesionit, për fajin e tij, duke i shkaktuar në këtë mënyrë një dëm prej 158,000,000.00 euro (njëqind e tetë milionë euro).

REAGIMI



Humbi gjyqin në Arbitrazh, Becchetti: Nuk mbaron këtu

Shteti shqiptar fitoi në muajin janar në Arbitrazhin Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë padinë me biznesmenin italian Francesco Becchetti në lidhje me hidrocentralin e Kalivaçit, ekzakhtësisht kundër shoqërisë "Hydro" S.R.L. në pronësi të tij. Menjëherë pas shpalljes së vendimit, me anë të një reagimi, përfaqësues të shoqërisë së Becchetti-it e cilësojnë vendimin të pjesshëm dhe të fituar me prova të rreme. Ata thonë se çështja nuk mbyllet me kaq.

REAGIMI I KOMPANISË

"Hydro S.R.L. ka detyrimin të saktësojë se vendimi i dhënë nga gjykata e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë është një vendim i pjesshëm, për të cilin nuk është bërë asnjë cilësim vlerë dhe për të cilin vetë gjykata është e rezervuar. Është me vend të qartësohet se ky vendim i pjesshëm nuk ka marrë në shqyrtim provat e depozituara lidhur me shpërndarjen e koncesionit, sepse ato janë dorëzuar më vonë. Përkundrazi, arbitrat ftuan 'Hydro S.R.L.' për të fituar një arbitrazh të dytë. 'Hydro S.R.L.' më 30 qershor 2017 njofton qeverinë shqiptare dhe ministrinë e Energjisë për kërkesën e dytë për arbitrazh, në të cilën nga 'Hydro S.R.L.' iu kërkuar të konstatojë: Keqbesimin kontraktor nga ana e ministrit të Energjisë për krijimin e provave të rreme nëpërmjet agjencisë në varësi të tij. Administratori i hidrocentralit Cecebelli deklaroi: Unë do të sugjeroja që për të informuar publikun shqiptar në mënyrë transparente, ministri Gjilkuri duhet të presë derisa të shpallet vendimi përfundimtar i arbitrazhit, rezultate e shumë çështjeve të tjera që janë në zhvillim".



 REPUBLIKA E SHQIPERISE

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitit pranë Gjykatës Kushtetuese (KPA), bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjykatëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit".

1 - Shpall vendin vakant për pozicionin "Specialist Sekretarë Gjyqësorë"

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për tu pajisur me Çertifikatë Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.


Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 20 Shtator 2018, i cili duhet të vërtetohet me Letër-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator 2018 në adresën: info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jete shkirim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislativacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimeve positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al



 REPUBLIKA E SHQIPERISE
 BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje dhe instalim i sistemeve të vëzhgimit për nevojat e degeve të Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 126,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkeje me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttes: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje dhe instalim i sistemeve të vëzhgimit për nevojat e degeve të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Zef Picaku: Humbi jetën si hero, mbrojti 16-vjeçaren italiane teksa dhunohej

Vrasja e Viktorian Picakut në Itali, vëllai i viktimës: Krim i paramenduar

“Kërkoj drejtësi, autorët tentuan të më vrisnin edhe mua”

Ina Allkanjari

Humbi jetën si hero”. Kështu shprehet vëllai i 24-vjeçarit Viktorian Picakut, i cili humbi jetën tragjikisht në Itali, vetëm se shpëtoi nga duart e dhunuesit një vajzë italiane. Ishte 30 korrik i këtij viti kur i riu ndërhyri për të ndihmuar një vajzë që po dhunohej nga ish-i dashuri i saj italian, Domeniko Manzine në mes të sheshit “Abazia” në Corado të Italisë, pa menduar kurrë se pikërisht në këtë çast, kishte “firmosur” vdekjen e tij. Zef Picaku, i vetmi dëshmitar i ngjarjes së rëndë, tregon për “Gazeta Shqiptare” se ajo që ndodhi ishte krim nga dora e një gjakftohti. Ndërsa në Itali është duke u zhvilluar gjyqi ndaj dy autorëve, të cilët kërkojnë të lehtësojë barrën ligjore, duke thënë se donin vetëm t’i trembnin vëllezërit. Ndërkohë, 26-vjeçari ruan me fanatizëm në telefonin e tij bisedën e fundit të vëllait të ndjerë me motrën, ku teksa nisej për Itali i lë “amanet” të kujdeset për nënën. E ruan si një kujtim të veçantë që sipas tij, jetëson njeriun e rrallë që ishte vëllai i tij i

vogël, një hero.

Si lindi konflikti mes vëllait tuaj, Viktorian Picakut dhe dy autorëve. A ishit ju në dëjani të debatit?

Në datë 30 korrik, isha bashkë me të dashurën të sheshi “Abazia” në Corado. Rreth 30 metra larg meje ndodhej vëllai im me tri shoqe. Një djalë italian, të cilin e njihja vetëm si pamje, i afrohet njërit prej gocave dhe filloi ta dhunojë fizikisht. Në ato momente shoh vëllain që ndërhyr për ta ndaluar dhe i thotë që të mos e qëllojë pasi është femër dhe është minorene. Pas ndërhyrjes së vëllait, italiani filloi të debatonte me tone të ashpra me Viktorin. Afrohem drejt tij dhe në ato momente italiani largohet.

Pas përplasjes me italianin, si reagoi vëllai juaj?

Vëllai nuk e dinte mirë gjuhën italiane, më tha që u përpoq t’i shpjegonte që të mos e dhunonte vajzën. Pasi italiani u largua, vajza më tregoi se ishte ish-i dashuri dhe nuk e kuptonte regimin e tij dhe arsyen pse debatoi me Viktorin. Pas kësaj ngjarjeje u larguam në shtëpi, tri ditë më vonë më mori vëllai në telefon dhe më tha që e kishte kontaktuar italianin, të cilin as emrin nuk ia dinim. Por njëheshim si pamje, sepse jetonim në të



Zef Picaku, vëllai i 24-vjeçarit Viktorian Picaku

njëjtën zonë. Më tha që do shkonte ta takonte dhe mendoj se italiani do i kërkonte ndjesë, pasi ishte i pafajshëm në këtë histori. Menjëherë u nisa edhe unë drejt vendit ku kishin lënë takimin, përsëri të sheshi “Abazia”. Sapo arrij në shesh, shoh vëllain nga larg. Në ato momente pranë meje kalon me motor italiani së bashku me një shok tjetër. Ndalon motorin pranë vëllait dhe zbrit me një shkop bejsbolli në dorë. Sapo pash shkopin, vrapova

drejt vëllait, por personi në fjalë nxjerr pistoletën dhe e qëllon vëllait para syve të mi. E pash teksa binte në tokë, e qëlloi disa herë dhe u afrua ta qëllonte edhe në kokë që të ishte i sigurt që kishte vdekur. I dal përpara dhe i kap dorën, në ato momente më qëllon dhe mua. Shpirti i vëllait më mbrojti, nuk e di si nuk më kapën plumbat, ishim shumë afër.

Çfarë ndodhi më tej?

Nuk po kuptoja më asgjë, erdhi policia, nuk donin të më tregonin që vëllai kishte vde-

APELI

Zef Picaku, një shqiptar nga Mirdita, kërkon drejtësi për vëllain e vranë në sytë e tij në Itali, në gusht të këtij viti. Viktorian Picaku shpëtoi nga dhuna e ish-të dashurit një vajzë 16-vjeçare italiane, por ai e ekzekutoi me pistoletë. Vëllai i mbetur gjallë kërkon dënimin maksimal për italianin dhe shokun e tij, që po mundohet t’i shpëtojë drejtësisë.

atën. Thonë që gjithçka e bënë për ta trembur, nuk donin ta vrisnin. Ata ishin gjakftohtë. Pasi e qëlluan disa herë, tentuan ta qëllonin edhe në kokë që të siguroheshin që kishte vdekur. Më qëlluan edhe mua.

Cili është apeli juaj?

Vëllai im humbi jetën si një hero. Dua të vihet drejtësi mbi vdekjen e tij. Të verifikohen të gjitha kamerat e sigurisë. Ajo ishte një vrasje e paramenduar. Kërkoj që autorët të marrin dënim maksimal. Pas vdekjes së vëllait, një familje italiane e cila ruante anonimitetin donte të paguante për sjelljen e arkivolit në Shqipëri. Nuk pranuam, dyshoj se ky është një veprim i kryer nga familja e vrasësit për të shfaqur pendesë. Ndiheha sikur ma vranë vëllain për herë të dytë.

Cila ishte arsyeja që iu shtyu të merrni rrugën e vështirë të emigracionit?

Varfëria, problemet familjare. Mamanë e kam gjysmë të paralizuar, nuk punon dot. Babai është i sëmurë gjithashtu. Shkuam në Itali bashkë me vëllain që të tërhiqim prindërit. Ditën e fundit para se të ma vrisnin po më tregonte se nuk duhet t’i linim më prindërit vetëm në Shqipëri, por t’i merrnim për kurim në Itali.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Presidenti i 'European Chambers', Christoph Leitl kërkon marrëdhënie më të mira tregtare brenda rajonit. Mungesa e zbatimit të ligjit dhe korrupsioni janë pengesa për investime të huaja në Shqipëri.

Ani Ruci

Christoph Leitl: Investitori do siguri për investimin në Shqipëri



Christoph Leitl: Si president i Platformës Globale të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, e di se ?farë po ndodh rreth e rrotull. Rusia është e rëndësishme në Ballkan, SHBA kanë gjithashtu interesa në rajon. Ekonomia europiane është e hapur. Ne pretendojmë të njëjtën hapje edhe nga të tjerët. Duam rregulla të ndershme, konkurrim të ndershëm. Nuk ka problem nëse në rajon vijmë investitorë të tjerë. Ne duhet të dimë që

identiteti ynë është Europa. Ne kemi një interes të përbashkët evropian për rajonin.

Cfarë duhet që Zona Rajonale Ekonomike në BP, produkt i rëndësishëm i Procesit të Berlinit, të forcohet, të gjenerojë vende të reja pune dhe përmirësim të jetesës së qytetarëve në rajon?

Christoph Leitl: Më shumë besim në të gjitha nivelet. Në atë bashkiak, të qarkut dhe shtetëror: Këto 3 nivele nuk janë të lidhura,

nuk janë bashkëpunuese me njëra-tjetrën. Investitori kërkon besim dhe siguri.

Arsimi profesional, transferimi i dijeve, i zanateve tek brezi i ri janë përparësi për "Euro Chambers". Rinia e Shqipërisë dhe në përgjithësi e BP edhe kur e merr arsimin profesional, edhe kur ka një punë, synon emigrimin në Gjermani, Austri, SHBA, Kanada etj. Si e shihni këtë dukuri?

Christoph Leitl: Emigron sepse

ka pagë 2-3 herë më të lartë, perspektivë më të mirë jetese. Që brezi i ri të mos emigrojë duhet që këtë perspektivë ta ketë në vendin e vet. Brezi i ri duhet të ketë perspektivë jete, të ikë dhe rikthehet. Pra, jo 'mos ikni', por planifikoni kthimin e tyre. Në fakt, rinia në rajon po humbet durimin, perspektiva europiane në 2025 mund të shtyhet më tej.

A ka rrezik që zgjedhjet europiane në maj 2019 të ndikojnë negativisht në perspektivën europiane të BP, në politikën e zgjerimit të BE?

Christoph Leitl: Po, ka. Nëse forcat politike populiste, neo-nacionaliste dhe separatiste në Parlamentin Europian do të fitojnë, projekti i zgjerimit të BE me vendet e BP rrezikohet. Anëtarët e rinj të BE do të kenë nevojë për më shumë solidaritet, ndihmë, mbështetje. Nëse nuk ka vullnet politik për ta përbaluar këtë, atëherë projekti evropian është në një situatë të vështirë. Projekti evropian nuk duhet braktisur, identiteti evropian duhet tani më shumë se kurrë më parë.

** Christoph Leitl është politikan i njohur austriak, president i Dhomave Europiane të Tregtisë dhe Industrisë, president i Platformës të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.*

"Deutsche Welle": Cili është qëllimi i vizitës suaj në Tiranë?

Christoph Leitl: Shqipëria është pjesë e familjes sonë ekonomike europiane, ashtu si edhe 5 vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (BP) me Dhomat e tyre respektive të Tregtisë dhe Industrisë. Jam në Tiranë, pasi vendeve të BP u duhet dhënë më shumë perspektivë europiane. Nga ana tjetër, BE pret fakte, jo premtime nga këto vende, sidomos në dy drejtime: zbatimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Si president i 'European Chambers', konstatoj që marrëdhëniet tregtare mes 6 vendeve të BP nuk janë zhvilluar në dekadën e fundit. Si mund të futeni në tregun evropian, kur nuk jeni të aftë të keni marrëdhënie të mira tregtare në rajonin tuaj? Duhet forcuar bashkëpunimi mes vendeve të BP. Një nga fjalët e mia ky?e gjithmonë është "Së bashku".

Si do t'i përshkruani marrëdhëniet mes BE dhe BP nga këndvështrimi i biznesit?

Christoph Leitl: Ka shumë simpati, respekt për atë që ky rajon ka përballuar me forcat e veta. BE mund dhe duhet ta ndihmojë BP. Vende e tij, përfshirë edhe Shqipërinë janë pjesëmarrëse në disa programe të BE, të para pranimit. Kjo forcon lidhjet mes BP dhe BE. Për Shqipërinë kam një kritikë: duhet të bashkëpunojnë partitë kryesore, Dhomat e Tregtisë dhe të Industrisë. Në Shqipëri së bashku mund të bëni shumë gjëra, të bindni BE se jeni gati për anëtarësim. Nëse luftoni së brendshmi kundër njëri-tjetrit, kjo do t'ju kushtojë shumë burime, motivim dhe pranimiti i Shqipërisë do të vihet në pikëpyetje.

Cilat janë ankesat kryesore të anëtarëve të 'European Chambers', kur kërkojnë të investojnë në Shqipëri apo në përgjithësi në BP?

Christoph Leitl: Mungesa e zbatimit të ligjit dhe korrupsioni. Nëse nuk zbatohen ligjet, nëse nuk ka një bazë ligjore për investimet, për pronën, investitori evropian nuk vjen. Ai kërkon siguri për investimin e vet. Korrupsioni është helm dhe kush helmohet një herë, nuk vjen më.

Kur i shihni ju vendet e BP anëtare të BE? A është viti 2025, një datë realiste apo vendet e BP duhet të presin edhe përtej kësaj date?

Christoph Leitl: Nuk do të ketë një pranimit të përbashkët për vendet e BP. Çdo vend duhet t'i plotësojë vetë kapitujt e negociatave dhe të përmbushë pritshmëritë e BE. Psh., Shqipëria po bën shumë për të adaptuar legjislacionin e saj me atë të BE. Po kjo nuk do të thotë që në mënyrë automatike ndryshimet ligjore do të ndryshojnë realitetin. Korrupsioni nuk është kurrë formal.

Liderët e BP theksojnë që nëse perspektiva europiane shtyhet më tej në kohë, atëherë ka rrezik që aktorë të tjerë si Rusia, Kina, Turqia të rrisin pranimit dhe ofertat e tyre në një rajon me stabilitet vulnerabël dhe ekonomi të dobët si BP. Sa real është ky rrezik nga këndvështrimi i "European Chambers"?

Një 78-vjeçar e zuri korrenti, po lidhte kabllo të elektrike në shi

Stuhia "Florence", Trump e shpall Karolinën e Veriut "zonë fatkeqësie"



Për shkak të stuhisë "Florence", që goditi Karolinën, thuhet se një milion shtëpi dhe biznese mbetën pa energji elektrike, ndërsa stuhia tropikale "Florence" ka përfshirë një pjesë të konsiderueshme të jugut amerikan. Shtëpia e Bardhë njoftoi të shtunën se Presidenti Donald Trump e shpalli Karolinën e Veriut "zonë fatkeqësie". Ky vendim bën të mundur dhënien e fondeve dhe burimeve të tjera federale për përpjekjet e rimëkëmbjes nga stuhia. Qendra Kombëtare për Uraganet tha se stuhia ka shkakuar përmbajtje katastrofike në Karolinën e Veriut dhe të Jugut. Agjencia për motin tha se ekziston mundësia për tornado në pjesën juglindore të Karolinës së Veriut dhe verilindje të Karolinës së Jugut. Guvernatori i Karolinës së Veriut, Roy Cooper tha se "Florence" mund të shkaktojë komunitete të tëra. Uragani e uli fuqinë, në një stuhit tropikale kur goditi Karolinën e Veriut, nga uragan i kategorisë së parë me erëra shkatërruese dhe shira të rrëmbyer, duke shkakuar të paktën pesë të vdekur. Policia në Uillmington tha se një nënë dhe foshnja e saj humbën jetën, kur një pemë u rrëzua mbi shtëpinë e tyre. Një tjetër grua humbi jetën nga infarkti, ndërsa

ambulancat nuk arritën dot shpejt tek ajo, si rezultat i pemëve të rrëzuara. Një 78-vjeçar e zuri korrenti, ndërsa përpiqej të lidhte kabllo elektrike në shi. Një tjetër person humbi jetën kur erërat e forta e përplasën, ndërsa po kontrollonte për qentë e tij. Qendra Kombëtare për Uraganet tha se stuhia po ecën me ngadalë në brendësi me erëra të qëndrueshme, që kapin shpejtësinë 80 kilometra

në orë. Nga mbremja e së premtes, epiqendra e stuhisë ishte zhvendosur në Karolinën e Jugut. Lëvizja e ngadaltë e stuhisë, dhe jo forca e saj, është ajo që po shqetëson parashikuesit e motit dhe zyrtarët. Qindra njerëz në Karolinën e Veriut janë shpëtuar nga niveli i rritur të ujërave. Autoritetet thonë se kanë marrë më shumë se 150 telefonata vetëm në qytetin historik "New Bern" për të shpëtuar njerëz, pasi

ALARMI

Autoritetet thonë se kanë marrë më shumë se 150 telefonata vetëm në qytetin historik "New Bern" për të shpëtuar njerëz, pasi në shtëpitë e tyre kishte hyrë uji.

në shtëpitë e tyre kishte hyrë uji. Qendra e uraganeve parashikon deri në 101 centimetra shi për disa pjesë të Karolinës së Veriut. Të shtunën, stuhia me erëra me fuqi 75 kilometra në orë arriti në Karolinën e Jugut, në pjesën lindore të shtetit, rreth 85 kilometra në perëndim të qytetit-rezort "Myrtle Beach". "Florence" pritet të dobësohet të shtunën në mbremje, gjatë lëvizjes në brendësi të kontinentit.

Teatri, artistët politika... dhe publiku

NGA ARIAN LEKA

Nuk dua që të ndërpresësh pa filluar leximin. Aq më pak të pandehësh se dashkam të të them diçka poetike, si zakonisht. Po të them se i besoj prej kohësh vargu të *Sting*-ut, i cilit ngulmon të na thotë se dhuna nuk është zgjidhje, se asgjë nuk vjen nga dhuna dhe asgjë e mirë nuk mund të vijë kurrë prej saj.

Po ja që ashtu nisi. Në mënyrë të dhunshme. Teatri do të shembet! Shoqëruar me pikëçuditëse, siç e do drejtshkrimi i mbrojtur me ligj. Zhvendosur në hapësirën "do të" të së ardhmes së Shqipërisë (f)turistike. Kaq.

Pastaj gjithçka u nda në kampe përqendrimi. Sulme. Deklarata. Zëra pro prishjes së teatrit kombëtar. Marrëveshje të paqarta dhe po aq të pazbardhura sa dhe Marrëveshja e Çadrës. U shfaqën kundërshtarët, të heshturit, të spërdredhurit, të kamufluarit pas gjuhës alegorike me thirrje moralizuese. Aty përreth ishin edhe vëzhguesit "asas", që nuk mungojnë kurrë, ishte grupimi "edhe-edhe", të pranishëm që filmomin për të ushqyer rrjetet sociale, individë me fletë letre në gjoks, mbi të cilat shkruhej "unë jam teatri". Kishte mes tyre edhe nga ata që fjalën *Teatër* dhe fjalën *Kombëtar*, e shkruan me nistore të madhe, si për ta sentimentalizuar çështjen.

Ishte lënë pas dore diçka fare e thjeshtë. Fakti që duartrokitjet meritojnë jo vetëm në skenë, si aktorë, përgjatë dy orëve, por meritojnë çdo ditë, minutë pas minuti në jetën e përditshme. Bashkë me këtë mosvëmendje, ishte harruar edhe se çështja e sakrificimit "të së vjetrës që shembet" për të ndërtuar "botën e re" nuk ishte e para përvojë në historinë e kulturës shqiptare.

Nëse kujtojnë se çfarë ndërtesash kanë përreth sheshit Skënderbe, në rrugën e Kavajës, në rrugën e Durësit dhe në disa prej lagjeve të hershme tiranase, kuptojmë se mbi hartën tonë kulturore e reja e ka mundur të vjetrën, por jo duke ofruar gjithmonë më të mirën dhe më të bukurën.

Edhe pse jo të gjithë mblidhen në sheshin pranë teatrit,



kundërshtarët e shembjes takohen në të njëjtën pikë. I duhet Tiranës një teatër i ri? Sigurisht! Pika e ndarjes ishte se ky ndërtim nuk duhej bërë duke shembur të vjetrin dhe se fondet për ndërtimin e tij të duhet të ishin publike.

Në fillim u besua se zgjerimi i vë-

mendjes publike në mbrojtje të teatrit mund të arrihej lehtë. Mjafton të ironizoheshin "burrat e shtetit" - vendimmarrësit, mjafton t'i parqisje ata si leshko dhe injorantë dhe ja ku u fitua edhe një betejë. Ata duheshin bërë qesharakë, siç u mëtua përmes deklamimit të vargjeve

të Heine-s të Gjermania një përrallë dimri. Pas kësaj ata do turpëroheshin dhe do tërhiqeshin. Por në shtëpinë e të të përqeshurit dhe të tallurit sarkazma nuk prek njeri. Ndaj dhe kjo formë elegante e protestës pacifiste dështoi që në placentë.

➔ Vijon në faqen 14



Kërcënimi ndaj së vërtetës (Threat to truth)

Kërcënimi mediatik, lufta kibernetike, fake news, bota e madhe dhe e frikshme e mediave online, virtualiteti janë disa nga temat që ndërthuren këtë vit në Festivalin Ndërkombëtar të Tiranës, që njihet me akronimet IHRFFA.

Festivali Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut (IHRFFA), që kap edicionin e tij të trembëdhjetë në këtë vit, vjen i organizuar si zakonisht në muajin shtator. Aktiviteti mban si realizues Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi" dhe ka si temë kryesore të shënuar "Threat to truth" ("Kërcënimi ndaj të vërtetës"). Në të vërtetë, ky aktivitet që e ka vendosur Tiranën për çdo vit në një hartë të rëndësishme kontinentale të veprimtarive filmime kryesisht ato që lidhen me të drejtat e njeriut, ka fituar një prestigj të admirueshëm. Vazhdimësia e bën këtë aktivitet jo thjesht të respektuar por edhe të shumëpritur. Është pikërisht, kjo vazhdimësi e Festivalit të Akademisë së Filmit "Marubi", që e bën të mirëpritët dhe të marrë vlerësime. Por, mbi të gjitha organizatorët dinë të sjellin dhe filma me renome ndërkombëtare dhe të përzgjedhura me shumë kujdes. Që do të thotë pjesëmarrësit kanë pasur pjesëmarrje në festivale ndërkombëtare dhe madje mbajnë autorësi personazhesh realisht të vlerësuar. Fryt i kësaj është...

➔ Vijon në faqen 17

A

ARGUMENT

Autori parashtron idenë e tij për teatrin dhe çdo gjë që lidhet me të. Po çfarë përfaqëson teatri sot dhe pse i tremben fuqisë së tij? Ndonëse u flet audiencave të kufizuara, teatri vazhdon të mos bindet. Për logjikën e teatërshembësve, teatri duhet shembur edhe për arsye të tjera. Përveç periudhës komuniste, kur u përul, teatri nuk i ka përmbushur kurrë pritshmëritë e pushteteve, shprehet autori. Ky plak-fëmijë-rebel ka treguar se është më i fuqishëm se mediat, më i fuqiplotë se gazetat e blera në dhjetëra vjet përmes njoftimeve qeveritare dhe granteve, më ndikues se portalet e sponsorizuara dhe më i lirë se televizionet. Teatri nuk është si Kuvendi-Parlamenti, ku duartrokitjet delegohen si vota dhe pushteti...

Teatri si formë ndëshkimi



NGA ARIAN LEKA

Vijon nga faqja 13

Fakti që në skenën e improvizuar mes dy teatrove vendin e vargjeve të Heines-s e zuri deklamimi i poetëve shqiptarë të periudhës së zgjimit kombëtar, la të kuptohej se "çështja teatër" jo vetëm që do i zgjeronte përmasat, por do të përdorej nga shoqëria civile dhe do shpërdorohej nga prejka e politikës, duke u paraqitur si "çështja Shqipëri".

Një gjë ishte e qartë. Ndodhia do kishte të humburit e saj, "viktima të keqdashjes dhe të keqkuptimeve", por nuk do e përdorte sloganin "me ne fitojnë të gjithë". Me shembjen e teatrit nuk fitonin të gjithë. Përfitonin vetëm, disa. Kjo ishte e qartë, si lufta që bëhej për truallin e jo thjesht për nostalgjinë dhe për godinën.

Prireja për vringëllimë të fjalës dhe politizim u bë më e dallueshme pas deklaratave, që filluan ta lidhnin teatrin me kujtesën dhe shembjen e tij me rrënimin e trashëgimisë kombëtare gjatë tranzicionit të gjatë. Por pas kundërshtimeve u kuptua se po zgjohej konflikti, sidomos kur tonet u bënë epike dhe kur vendin e parabolave dhe alegorive femënore mbi teatrin të botuara në shtyp e zuri vjersha *O moj Shqypni* (me vargje të aktualizuara sipas kontekstit teatër). Tonet kushtimorë arritën kulmin në këndimin në grup të vargjeve "Eja mblidhuni këtu". Mund të mos jenë më kulmorët e poezisë shqiptare, por këto vargje, për fatin tonë të keq, edhe pas një shekulli e gjysmë, vijojnë të mbetet aktuale.

Taktikisht dukej se ishte vepruar mirë në çdo hap. Por për të qenë të kthjellët, a ka me të vërtetë diçka për t'u krenuar në aktualizimin e vargjeve që u zgjodhën për të mbrojtur teatrin? Aspak. Fjalët e Pashko Vasës, të Mihal Gramenos, të Migjenit, të Konicës e të Mid'hat Frashërit (të cilët i citojmë vend e pavend nga kafenet në Kuvend) nuk janë të pavdekshme dhe nuk u flasin "shekujve që vijnë". Nuk ka vend për mbivlerësim. Autorët tanë nuk flasin "urbi et orbi". Autorët e nderuar nuk janë dhe nuk ka pse të jenë aktualë, por bëhen të tillë, pasi edhe pas 100 vjetësh kumtet e tyre përputhen me realitetin tonë.

Aktualizimi i këtyre shkrimtarëve prej nesh na e thotë në sy atë që duam ta fshihim. Vendi ynë ka ngecur. Lëviz, por xhiron bosh, për inerci, pa qëllime të qarta, në zbrazti. I kemi lënë të pazgjidhura çështjet e kujtesës dhe të trashëgimisë, për të cilat na

qortonte Konica, Noli dhe Mid'hat Frashëri dikur kemi mbetur po ata. Njerëz të ngjashëm në vese, por jo në virtyte, me paraardhësit tanë. "Thumb i ngulur ndër trutë e njerzsis", do na shkruante Migjeni, që nuk bindim dot as veten të besojë se "këtu rron një popull që ndërton diçka të re..."

Atyre që e ndoqën zhvillimin e protestës nga ekrani ky aspekt i rikthente gjendjen *deja vu*. U dukej se e kishin përjetuar edhe herë të tjera këtë protestë, peticionet, grevat e urisë. Përvoja u thoshte se asgjë nuk ka ndryshuar dhe nuk ndryshon në këtë vend, ndaj dhe, përveç arsyeve të tjera që kanë lidhje me kulturën e bindjes dhe politikën, nuk i afroan protestës.

Nuk ka pra vend për ngazëllim nëse vlerësojmë lidhjen tonë me kulturën dhe artin. Nuk kemi pse krijojmë iluzione se artistët, teatri, poeti dhe arti poetik a dramatik vlejnë diçka për jetën e këtij vendi. Kultura dhe arti për ne nuk kanë vlerë të përditshme. Kujtohem për to vetëm kur na shërbejnë për diçka pragmatike, si në rastin e leximit publik të poezive në mbrojtje të teatrit. Në rastin e teatrit u kujtuam për njerëzit e fjalës pasi, me mendësitë e vetme që zotërojmë, ato jakobine, bolshevikë dhe yxhym-yrysh, ne besojmë fort se forma e vetme e artit që ekziston në Shqipëri dhe që duhet të ekzistojë është ajo e artit bombë e flamur, vetëm lloji i artistit që çirret dhe bën ekzibicion në ekran.

Prej vitesh na e kanë përplasur në sy. Artisti i duhet shtetit vetëm që shteti të përligjë ekzistencën e pozës së tij prej bamirësi. Vetë shteti ka marrë pamjen e një agjencie funeralesh, që organizon përcjellje melodramatike dhe festa jubilarë, ku artisti shfaqet si statistikë, si inventar dhe si sfond i përkultur. Po të

kishte nderim për kulturën dhe artin, diskutimi "të prishet apo të ruhet teatri" nuk do të bëhej fare. Debatu publik do përqendrohej se ku dhe si të ndërtojmë teatro në çdo shkollë publike, teatro për çdo njësi bashkiake, njëllor siç për fat të mirë, po ndërtohen palestra në shkolla, por që dhe kënde lojrash në brendësitë me pallateve.

Edhe për teatrin u kujtuam në të njëjtën mënyrë: vetëm kur duan ta shembin dhe jo kur duhet ta bënim të hapur dhe më të mirë. Ne nuk jetojmë me artin dhe as përmes artit. Njëllor si në periudhën e realizmit socialist, ne e thërrasim artin si flakëndezës. Duam që teatri në Shqipëri të jetë multifunksional. Duam që teatri të përdoret për shërbime urgjente, emergjente dhe ambulante. Duam që teatri të jetë në shërbim apo t'i ngajë sapunit për të pastruar duar, shpirtin dhe paratë më së fundi. Por e dimë dhe nuk mund ta fshihim se më shumë se sa prej atyre që kanë vendosur shembjen, teatri është kërcënuar të fundoset nga vetë. Ka nisur vite më parë.

A thua e kemi harruar se rrënimin i tij ka nisur jo nga muret, se teatri përfaqësohet nga muret po aq sa telat e sotëm me gjemba përfaqësojnë Auschwitz-in apo dërrasat e restauruara përfaqëson teatrin *Globus*. Është punuar me strategji.

Humbja e respektit për teatrin dhe njerëzit e tij do e bënte më të lehtë shembjen. Teatri u bë i parëndësishëm përballë syve të pub-

likut. Teatrit iu rrëzua kurora nga koka dhe e humbi aureolën të cilën sot themi se e ka ende përreth. Teatri Kombëtar i Tiranës u bë një objekt i rëndomtë, në mjediset e të cilit një herë viheshin baste, një herë luheshin pjesë teatrore dhe herë të tjera ishte restorant, siç kishte qenë gjykatore vite më parë.

Teatri u ç'rëndësua. Ai ishte rrëzuar përballë syve të publikut kohë më parë se fadromat t'i sillëshin përqark për t'i nxjerrë themelet dhe shpirtin. Propozja kishte nisur jo nga muret dhe fasada, por nga brenda skenës. Repertori i vakët, bordet artistike të mbushur me individë palidhje të genësishme me teatrin, emërimet politike të mbuluara pas konkurseve pa konkurrentë, nga zgjidhjet anakronike regjisoriale dhe nga loja e zbehtë e aktorëve.

Rënia filloi nga përjashtimi i dramaturgëve dhe i aktorëve të mirë, nga afria e komedisë vulgare vetëm e vetëm për të mbushur statistikën e rreme të kthimit të spektatorit në teatër, nga largimi i teatrit të vërtetë, klasik, modern apo bashkëkohor si dhe nga mungesa e vizionit që teatri të bëhet domosdoshmëri për jetën e një kryeqyteti. Me këtë sipërmarrje rrënimin mund të mburrem. Aty jemi bashkaksionerë.

Duket sikur debati publik mbi teatrin

Pse u kujtuam tani për teatrin

Ne nuk jetojmë me artin dhe as përmes artit. Njëllor si në periudhën e realizmit socialist, ne e thërrasim artin si flakëndezës. Duam që teatri në Shqipëri të jetë multifunksional. Duam që teatri të përdoret për shërbime urgjente, emergjente dhe ambulante. Duam që teatri të jetë në shërbim apo t'i ngajë sapunit për të pastruar duar, shpirtin dhe paratë më së fundi. Por e dimë dhe nuk mund ta fshihim se më shumë se sa prej atyre që kanë vendosur shembjen, teatri është kërcënuar të fundoset nga vetë. Ka nisur vite më parë.



kombëtar është shteruar. Atij nuk mund t'i shtosh më asnjë fjalë. Sidomos pasi u botua artikulli i Aurel Plasarit, që i shtjelloi në detaje të imta arsyet se teatri jo vetëm që nuk duhet shembur, por duhet mbrojtur si "monument shumëfish historik, - i historisë kulturore, i historisë artistike, i historisë sociale, i historisë së albanologjisë, i historisë politike të shtetit shqiptar".

E njëjta gjë mund të shprehet qëkurse Maks Velo tha se "teatri nuk duhet të prishet, ai mund të restaurohet", duke ofruar me këtë rast argumentet e tij. Të dy këta autorë iu drejtuan kryesisht atyre që qeverisin vendin tonë. Ndryshe prej tyre, Fatos Lubonja zgjodhi rrugën tjetër, duke iu drejtuar opozitës, të cilën e ftoi/sfidoi të "djegë" mandatat parlamentarë, si një mesazh "se këtu nuk funksionon demokracia" dhe se "djegia e mandateve është akti i fundit për të treguar se këtu nuk kemi një situatë normale".

Duket vërtet sikur nuk mbeti hapësirë as për ata që besuan, as për ata që dështuan, as për ata që u treguan skeptikë, as për specialistët, që u shprehën "pro" shembjes me argumente teknike, as për ata specialistë që u shenjuan si qëndrestarë ngaqë e

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e zakonshme. Shkrimi kryesor iu la një argumenti të Aristotelit Micit për Apoloninë, me sensin e shpjegimit që Spinarica e Vjosës ishte port. Duhet të sqarohet se ishte një shkrim pjesë e një hulumtimi të gjatë, që kishte bërë autori, dhe që kishte dhe shumë material të rëndësishëm, por gjithsesi, dukej i tepërt për "Milosao", sepse zuri shumë faqe. Në fakt, i ngjante një shkrimi didaktik, por shqiptarët kanë kohë që nuk lexojnë. Redaktori e vendosi edhe pse në morinë e gjërave që kishte, ky shkrim i përshatej për të mbyllur numrin, që vuante realisht.

"Në këtë qytet do të ndërtoheshin pallate luksoze e faltore madhështore, si tempulli i Artemidës, godina e administratës qeverisëse, biblioteka, odeoni, theatri i Madh. Një burim nga antikiteti tregon që Apolonia lidhej me detin Adriatik me anë të Vjosës, që kalonte nëpër trevat e saj, në faqen lindore të qytetit, ku duhej të këtë qenë një port lumor. Por kur shikojmë sot gurët e shtërmedhënj të murit ciklopiq, në hyrje të tempullit të Artemidës, si edhe gurët e tjerë të godinave antike, del pyetja se si janë mbartur ata gurë me ato pasha dhe përmasa aq të mëdha vetëm nëpërmjet një porti lumor? Pyetja tjetër që del është se nga janë gjetur ata gurë të rëndë për ato ndërtime?! As fushat, dhe as kodrat e Myzeqesë nuk kanë asnjë lloj guri. Pra, ata gurë duhet të jenë sjellë nga vende të largëta, ndoshta nga ishujt shkëmborë të Mesdheut a po të detit Egje. Dhe mjeti kryesor për t'i mbartur deri tek porti lumor i Vjosës duhet të kenë qenë anijet e asaj kohe. Po a do të ishte i mjaftueshëm vetëm porti lumor i Vjosës për të përballuar gjithë ato mijëra e mijëra tonelata me gurë?! Dalin dy arsye që të bëjnë të dyshosh se porti lumor i Vjosës ka qenë mundësia e vetme e

lidhjeve të Apolonisë me detin". Artikulli kishte nevojë për redaktim, por kushtet tonë nuk e lejojnë më.

Redaktori botoi një cikël të shkrimtarit Moikom Zeqo nën përkthimin e mirë të Petro Çerkezit. Layout hoqi shumë për të përshatur poezitë në gjuhën e huaj. Duhet thënë se shkoj mirë dhe qartë, paqka se përkthimi i poezive ishte në greqisht dhe kuqtohet që karakteret greke janë të vështira për grafikën. Redaktori iu desh t'i mbushë mendjen layout që duhej të sforcuhej disi në këtë rast.

Vetë redaktori shtoi një shkrim dhe bëri një paralelizëm me shkrimtaren e njohur bjelloruse, nobeliste Svetlana Aleksievic, që për një koicidencë të rastit bashkoi dy emra: përkthyesin e saj Xhimi Lazri dhe të atin, Sofokli Lazri. Nobelistja bjelloruse u përkthye menjëherë në shqip, por redaktori shtoi një argument, që lidhej me nobelisten. Duhet parë gjithnjë dhe kahu i kundërt i rëfimit patetik. "Shqipëria është e tejmbushur me pseudo të dashënës dhe histori të stisura që e bëjnë qesharake një narracion të tërë, ashtu si komunistët do të dojnë me ngritjen e një idili lufte, që në të vërtetë nxori zbuluar shpesh gjëra të paqena dhe herojë të stisur. Ndaj, për këtë duhet letërsia dhe njerëzit e drejtë, ata që i vlejnë çdo rrëgjim sepse i duhen vetë historisë. Asaj të thjeshtës, që e bënë njerëzit realë".

Haxhia na kish sjellë një shkrim me një zhanër të çuditshëm për Maxim Osipov, duke ndërthurur lajmin, krijimtarinë e tij dhe rrefimin. Çuditërisht, kish harruar pa përmendur përkthyesin e veprës. Numri ishte fare i zakonshëm dhe duket se redaktori është në një letargji momentale, që duhet kaluar.

kundërshtuan shembjen, as për "tradhtarët e të shiturit". Nuk mbeti vend as për autoritetin dhe disiplinën e specializuara të urbanistëve, as për të përballurit dhe as për zërat që mendojnë si Yasmina Reza, se teatri mbetet reflektim i mprehtë i shoqërisë dhe se dramaturgët më të mëdhenj kanë qenë dhe do të mbeten mbrojtës të së drejtës dhe të moralit.

Tani që edhe votimi parlamentar për ta shembur teatrin u krye dhe u vendos për "PO", mbetet të pyesim dhe ta gjejmë përgjigjen pse njerëzit e përfshirë në politikë dhe në jetën parlamentare të vendit tonë (nuk po i cilësoj politikë) dhe kishin kaq të lehtë ta merrnin vendimin për shembjen e teatrit? Përse kjo armiqësi?

Ka nga ata që besojnë pa të keq se shkak i armiqësisë fshihet te rivaliteti teatër-skenë dhe ironisë së "teatër politik". A thua po hakmerrej politika për fyerjet dhe poshtërimin që u kishte bërë me vite në skenën e teatrit kombëtar të Tiranës Aristofani, Sofokliu, Miller-i, Shakespeare apo Brecht? Apo parlamentarëve u erdhi rasti i munguar për t'u hakmarrë për bezdinë që teatri u ka shkaktuar në mijëra vjet të pushtetmbajtësve? Nuk e besoj. Nuk i kemi aq sqimatarë dhe cipëhollë njerëzit që na drejtojnë. Kjo formë hakmarrjeje do i nderonte shumë parlamentarët tanë. Shpjegimi i tillë do u varte atyre në qafë medaljen e meritës që nuk e kanë: njohjen se përfaqëson teatri



Në teatër gjithçka është e drejtpërdrejtë

Në teatër gjithçka është e drejtpërdrejtë, siç një demokraci duhet të jetë. Fuqia e teatrit mbetet te përballja e drejtpërdrejtë me publikun dhe publiku është një nga format më të sinqerta të elektoratit. Publiku vihet përballë veprës, personazheve dhe fateve në sallën e vogël të teatrit. Ky elektorat i teatrit është aq besnik sa për ta siguruar marrëdhënien me skenën, publiku nuk paguhet, si nëpër mitingje, por e paguan vetë detyrimin e tij ndaj trashëgimisë dhe kulturës vendase dhe botërore.

për jetën e një vendi.

Realiteti tregon ndryshe. Marrjen me lehtësi të një vendimi të tillë së pari u kemi lehtësuar vetë ne. Mes nesh janë shumë prej atyre që protestuan në fillim e që u larguan më pas, të tjerë që heshtin dhe ata që bëjnë gjoja apo vazhdojnë të protestojnë që teatri të mos shembet. Vetë ne investuam prej vitesh në shndërrimin e teatrit kombëtar në një hapësirë gajasjesh dhe vulgariteti.

Me naivitet apo me pragmatizëm sipërfaqësor, publikut i është hedhur hi syve kur rikthimi i spektatorit në teatër u mbivlerësua përballë mënyrës dhe formës se si ky publik po hyn në teatër dhe çfarë vlerat merr në sallat e tij. Ky banalitet i ngritur strategji për të qëndruar në majë të pushtetit kulturor, ky shkatërrim i organizuar i shijes së publikut, ua ka lehtësuar punën atyre që mendojnë se teatri kombëtar prej dekadash nuk sjell vlera dhe për këtë shkak duhet shembur godina bashkë me historikun e tij.

Me gjithë mëkatet, fjala qortuese nuk duhet shpenzuar e gjitha për ata që nuk kanë tjetër pushtet jashtë skenës. Në këtë kohë kur gjithçka u shndërrua në mall dhe këtij malli iu vu një çmim, disa syresh e kanë

përnjimend luftën dhe përpiqen ta mbrojnë teatrin me aq sa dinë, me aq sa mundën dhe me aq sa i lejojnë.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e atyre që votuan në parlament e kishin të lehtë të votonin "PRO" shembjes së teatrit pasi nuk kanë guxuar/denjuar kurrë të hyjnë goftë dhe një herë të vetme në marrëdhënie me teatrin apo të marrin pjesë si spektator në shfaqjet teatrorë. Ndryshe ata do e kishin kuptuar se prania në teatër është mënyra më e mirë e çdo shoqërie për të mbajtur të gjallë debatimin me veten, siç shprehte Peter Hall. Përveç përpjekjes sonë të përbashkët për ta bërë të pavlefshëm, të pabesueshëm, të vdekshëm teatrin, të mungesa e marrëdhënies me të shoh shkakun tjetër që ua lehtësoi vendimmarrjen politikëbërësve tanë. Kjo pasi gjërat që nuk i njeh, ato me të cilat nuk ke intimitet dhe nuk krijon ndjeshmëri, mund t'i vrasësh lehtë, ftohtë, pa shfaqur pendesë, edhe me një votë.

Ja pra, ku e gjetëm edhe arsyen për të mos shkelur kurrë në teatër dhe për ta shkallmuar që nga themelet teatrin kombëtar të Tiranë! Paskemi qenë dikur vendi i parë ateist? Një vend pa kisha, pa xhami, pa teqe

dhe dinagogë? Le ta përsërisim faqen e ndritur të historisë! Le të bëhemi i pari dhe i vetmi vend ateator në botë.

Por një arsye edhe më bindëse sesa ndihma që u kemi dhënë, me apo pa vetëdijë teatërshembësve dhe se mënia shekullore me teatrit dhe politikës qëndron te mosbindja. Teatri është fajtori i tretë. Ata që votojnë me lehtësi për shembjen e një teatri e dinë fare mirë se teatri është i pabindur. Teatri është kundërshtar. Kush dëshiron të mendojë me kokën e e tij e ka të qartë se teatri ka mbetur i vetmi entitet ende i panënshtuar. Dhe, nëse kryeneçësia është një krim, jo vetëm teatri kombëtar i Shqipërisë, por të gjithë teatrot në botë ta shpaguejnë për mosbindjen. Ata duhen shembur dhe duhet të ndëshkohen siç ndëshkohen mosbindjet.

Po çfarë përfaqëson teatri sot dhe pse i tremben fuqisë së tij? Ndonëse u flet audiencave të kufizuara, teatri vazhdon të mos bindet. Për logjikën e teatërshembësve, teatri duhet shembur edhe për arsye të tjera. Përveç periudhës komuniste, kur u përul, teatri nuk i ka përmbushur kurrë pritshmëritë e pushteteve. Ky plak-fëmijë-rebel ka treguar se është më i fuqishëm se mediat, më i fuqiplotë se gazetat e blera në dhjetëra vjet përmes njoftimeve qeveritare dhe granteve, më ndikues se portalet e sponsorizuara dhe më i lirë se televizionet. Teatri nuk është si Kuvendi-Parlamenti, ku duartrokjet delegohen si vota dhe pushteti.

Në teatër gjithçka është e drejtpërdrejtë, siç një demokraci duhet të jetë. Fuqia e teatrit mbetet te përballja e drejtpërdrejtë me publikun dhe publiku është një nga format më të sinqerta të elek-

toratit. Publiku vihet përballë veprës, personazheve dhe fateve në sallën e vogël të teatrit. Ky elektorat i teatrit është aq besnik sa për ta siguruar marrëdhënien me skenën, publiku nuk paguhet, si nëpër mitingje, por e paguan vetë detyrimin e tij ndaj trashëgimisë dhe kulturës vendase dhe botërore.

Por a qenka ndokush kaq i pasur sa ta pagujë një shfaqje të mirë teatri? Sidomos me një biletë? Kaq pak, një për të qenë pjesëmarrës në ndodhitë më tronditëse të botës dhe për të ripërtjetuar historinë? Me aq pak parë mund ta zgjojë kujtesën, mund ta pastrojë vetëdijen nga zmërçet? Pajesën e tij të vërtetë për një shfaqje të mirë publike e shlyen duke pranuar kushtet e rënda që teatri dikton. Mbyllyjen (herë herë si në një çmendinë). Anonimatin. Vetminë. Qëndrimin për rreth dy orë në errësirë. Dhe jo vetëm kaq. Teatër do të thotë zhvillim i një forme të lartë të demokracisë. Teatri është vendi ku nuk shkohet që të të dëgjosh, por që të dëgjosh, të bindesh, ta humbasësh veten.

Teatri është vendi ku hyhet për ta lënë pas krahëve madhësitë. Aty shkohet për t'u ndjerë se je i parëndësishëm, për t'u lënë radhën të tjerëve që kanë diçka të rëndësishme për të të thënë qetë apo me ulërimë. Ky është pakti për t'u bërë pjesë e një shfaqjeje teatrorë. Kjo është marrëveshja dhe marrëdhënia. Teatër do të thotë ta përballosh i heshtur gjithë sa ndodh në skenë. Bindje që, edhe pse gjendesh i rrethuar nga të tjerë, duhet të qëndrosh stoik, vetmitar.

Vetë kështu teatri është rregull dhe disiplinë. Duhet t'u bindesh edhe orareve. Të pranosh radhën dhe vendin ku të kanë caktuar të ulesh. Të rrihsh për krahu të panjohurve që të ndodhen pranë, të cilët as të njohin, as të nderojnë dhe aq që duan të dinë se kush je. Ata kanë ardhur të shohin teatër.

Pikërisht me ata që ndodhen aq rastësisht pranë teje duhet ndash ato që nuk ndahen dot të gjithë: emocionet. A do e përballonin dot këtë metodikë të vështirë pushtetarët tanë dhe ata që miratojnë ligje, vendime, amendamente dhe akte nënligjore? Thua të jetë kjo frika që i bën t'i rrinë larg teatrit dhe të ushqejnë aq shumë armiqësi ndaj tij a ta dënojnë brenda një minuti me rënim? Përtej kësaj, a do të mundeshin ta provonin pushtetmbajtësit që votuan pro shembjes së teatrit ndjenjen e të qenit i barabartë me të gjithë, ndjenjen e çlirimit, të katharsisit dhe të empatihisë? Por mbi të gjitha a do të mundeshin ta përballonin atë që përjetojmë shpesh brenda sallës së teatrit: ndjenjen e turpit apo të fajit ndaj diçkaje që nuk e kemi kryer ne vetë, por paraardhësit a bashkëkohësit tanë? Druaj se jo.

Ne nuk e paguajmë dot teatrin dhe as aktorët e tij përmes biletës simbolike të një shfaqjeje. Ne paguajmë me emocionet tona për krimin, fajin dhe turpin që njeriu ynë, njerëzit tanë dhe i gjithë njerëzimi kryen çdo ditë, siç ka kryer në shekuj. Sepse jemi pjesë e botës. Sepse jemi të përfshirë në njerëzim, siç shprehet poeti John Donne. Vetëm se kur shfaqja teatrorë përfundon kup-

➔ Vizion nga faqja 15

tojmë se sa pak kemi dhënë si shkëmbim. Atëherë zbulohet dhe na shfaqet nën një dritë të re qëllimi i vërtetë pse ndodhemi në teatër, pse kthehemi gjithmonë e më shpesh aty. Kuptojmë se në teatër nuk shkojmë për t'u zbatimur. Në teatër shkohet për të provuar shijen e ndëshkimit. Jo të ndëshkimit vetjak. Atij që priret nga sadomazokizmi. Por të ndëshkimit kolektiv. Në teatër shkohet për të besuar se ndëshkimi për krimet e ndodhura dikur dhe për krimet e padrejtësitë që vazhdojnë të ndodhin para syve tanë nuk ka përfunduar. Për të tilla ka kohë për një epilog. Ndoshta kjo është edhe një arsye përligjëse se pse shohim aq pak njerëz të politikës në sallën e teatrit, edhe kur i ftojnë.

A nuk është vërtetë cikinë të shohësh se ata që duartrokasin në sallën e teatrit, siç më ka qëlluar ta shoh disa shpesh, janë njerëzit që ndihmuan ndërtimin e rikrijimit e identitetit të tiranisë në vendin tonë? A ka gjë më trazuese se sa një diktator, një president autokrat, një kryeministër diktues, një politikan me tipare të sundimit autoritar, një ligjvënës apo një ligjshkelës i pandëshkuar, që duartroket dhe buzëqesh dikur pranë teje në përfundim të Rikardit III, Hamletit, Jul Qezarit apo të Henrit IV të Shakepeare-s? Po ky është teatri.

Dihet tanimë se skena teatrore dhe ajo e politikës kanë qenë shpesh në simetri. Më së paku që nga historitë antike të mbulura e deri tek "perceptimi i paradigms së përmbysjes pas ngjarjeve të tilla si shembja e komunizmit apo e ashtuquajtura "Pranvera arabe", siç mund t'i gjejmë të shprehura me hollësi të lakmuar në librin *Shakespeare and Tyranny*, ku, veç të tjerash, analizohen modelet shekspiriane të tiranisë në regjimet komuniste. Por kulmi i ironisë mbërrin kur urdhëruet e dhunës, të diktatit e të autoritetit të fortë, ata që përdorin teknikat e censurës, që blenë mediet, që marrin pushtetin me anë të dhunës, kanosjes dhe që nxitin vetë-censurimin, që vendosën kontroll mbi institucionet në shoqëritë post-diktatoriale të fortë tregojnë zell dhe ngjiten në skenë, për t'u dhuruar lule aktorëve, që luajtën rolet e tyre.

Për teatrot tona, kombëtare apo të periferive urbane, ky është një epilog i zakonit. Sepse vetë ne i lusim deri në pëstrosje politikanët tanë të marrin pjesë në premierat teatrore. Sepse vetë ne i shtyjmë oraret e fillimit të shfaqjes dhe e lenë spektatorin besnik të presë deri sa politikanët të mbërrijnë me 30 minuta vonë. Madje edhe regjisorë e aktorë nga ata që sot me të drejtën e tyre janë rreshtuar të kundërshtuesit e shembjes së teatrit kombëtar, politikanëve ua dërgojmë ftesat të parët. Atyre dhe jo ndokujt tjetër u zgjedhin vendet më të mira në plate, u rezervojnë llozhat, duke u dhënë rëndësi, kur veçse të rëndomtë janë.

U vu re se protestës kundër shembjes së teatrit i mungoi publiku. Nënshtrimi ndaj pushtetarëve e bëri publikun të kuptojë se jo vetëm institucionet shtetërore, por as teatri nuk është i tij. Publiku i është grabitur teatri, siç i janë falsifikuar dhe grabitur shumë të drejta në Shqipëri.

Spektatori i thjeshtë e ndjen se edhe aty, në sallën e teatrit, vendit ku duhet të ishin të njëjtë dhe ku mund të emotohej demokracia, ai është sërish i papërfunduar dhe i shpërfillur. Ai e ndjen se as teatri nuk mund të jetë më atdheu i tij. Teatri nuk është hapësira ku ai realizon utopinë për drejtësi sociale. Spektatori ndjen tradhëti. Ai pushon së besuari edhe heterotopinë e Michel Foucault-së, që e ka bërë të besojë se skena e teatrit ka aftësinë për të bashkuar në një vend të vetëm disa vende që në vetvete nuk përputhen.

Ndaj dhe teatërndjekësi fillon emigrimin, largohet. Ja dhe një arsye më shumë për të kërkuar azil politik! Shqipëria është një vend pa teatër. E morët vesh!? Shqipëria është një vend ku nuk realizohen të drejtat njerëzore, ku nuk përmblushen as ëndrrat dhe as liritë për të pasur teatër!

Arsye si këto (dhe përvetësimi i kauzës nga prania e politikanëve në një protestë publike, thua se u mungojnë rastet, komisionet dhe foltoret për të mbrojtur teatrin) dhe jo vapa, mungesa e edukimit përmes artit apo kampionati botëror i futbollit, neveria nga tubimet dhe nënshkrimet dhe madje ndonjëherë edhe vetë teatrorët, kanë qenë ato që e mbajtën larg qytetarin-spektator nga protesta në mbrojtje të teatrit.

Tëksa kemi përmendur fjalët shpëgjim, paguaj, mbyllur, faj, ndëshkim, hakmarrje, orare, kamp, vetmi apo heshtje kujtohem për logjikën që përdori Foucault, kur gjeti ngjashmëri mes burgut dhe teatrit. Te ky autor burgu përkufizohet si *teatër i terrorit*, që i përmban të gjithë elementet kryesore të *teatrit të horrorit dhe të ndëshkimit*. Të dyja format, edhe burgu edhe teatri, janë modele të ngjashme, krijuar enkas për ta transformuar njeriun përmes *torturës publike*.

Përmes torturimit publik kuptojmë se "burgu nuk është forma kryesore dhe e vetme e dënimit". Formë tjetër e ekzekutimit

ngesa e nderimit ndaj asaj që trashëguam.

Duhet qartësuar edhe diçka. Një shoqëri si e jona, që mbush gropa buxhetore jo përmes investimeve dhe punës, por me borxhe që i faturon publikut dhe përmes privatizimeve të pasurisë publike, duke mjellë lopën e vdekur të socializmit, paraqitet si një shoqëri me *sindromën down*, ku gjithçka mbërrin vonë dhe vepron ngadalë e mes kundërshtisht.

Në shoqëri të tilla lidhja mes dhuratës dhe dhuruesit ngjall ende frikë të dyanshme. Ky perceptim ndodh pasi i marrësi ndihet i dhunuar dhe vihet në gjendje varësie ndaj dhuruesit. Me fjalë më të thjeshta kjo do të thotë se në një rast si ai i diskutimit mbi shembjen apo ruajtjen e teatrit të vjetër dhe ndërtimin e një teatri të ri, është shteti dhe jo kush tjetër, autoriteti dhe entiteti i vetëm që mundet dhe duhet të bëjë një dhuratë. Jo aktorëve, por qytetarëve. Një pasuri publike, për publikun.

Kjo dhuratë duhet ofruar pa bujë, pa zhur-

Teatri si formë ndëshkimi



në publik është edhe teatri. Ndaj dhe nuk e duam. Ndaj dhe nuk e mbrojmë teatrin. Një institucion si teatri nuk ka të bëjë vetëm me vdekjen reale apo imagjinare të një personi/personazhi në skenë.

Teatri, para së gjithash sjell vdekjen e personalitetit brenda atij që merr guximin të ndjekë një shfaqje teatrore, qoftë ky një i ri pa përvojë apo një "burri shteti". Kështu, në këtë formë do të na kanosë dhe këshillojë Michel Foucault, sa herë që të marrim mundimin ta shfletojmë librin *Disiplinë dhe ndëshkim - lindja e burgut*. Por a na duhet të tilla labirinte dhe a mund të na ndihmojë Reza, Hall, Sofokliu, Shakespeare, Miller, Brecht apo vetë Foucault që nga varri, ku çështja shtrohet siç do e shtronte Hamletit-fare thjesht: teatri - të shembet apo të mos shembet? Po, është përgjigja për të gjithë ata që lindin dhe vazhdojnë lindin në shoqëri jo të varfra, por që varfërohen nga mu-

Fillimisht duhet kthyer mbrapsht *Ligji* që miraton prishjen e ansamblit arkitektonik të teatrit kombëtar. E tejkalon cinizmin që viti 2018 - vit që do të shënonte 80 vjetorin e nisjes së projektit nga arkitekti Giulio Berte, në fillim të vitit 1938 - të ishte njëherazi edhe vit i rrafshimit së teatrit kombëtar; sikur të na kishte zënë frymën apo sikur të mos kishte qenë aty ndonjëherë.

Certifikimi i shembjes si akt do i hapte udhën dhe do i jepte argument gjithkujt prej këtej e në vijim që të rrafshohet, duke filluar që nga amfiteatrit e Durrësit, te vepra e Philippe Parreno-s në hyrje të Kryeministrisë e prej aty te teatri në parkun e Liqenit e deri te sheshi Skënderbej, siç premtohet marrëzisht.

Nëse nuk mundemi ta ruajmë, ta mbrojmë e ta nderojmë çfarë trashëguam apo të ndërtojmë teatër të rinj, do të tingëllojë krejt boshe krekosja se mbi truallin e qyteteve të lashtë në trup të Shqipërisë së sotme gjenden aq e kaq teatro antikë.

Mos vallë u dashka që për shkak të vendimeve dhe sjelljeve të papërgjegjshme të

Teatri është rregull dhe disiplinë

Veç këtyre, teatri është rregull dhe disiplinë. Duhet t'u bindesh edhe orareve. Të pranosh radhën dhe vendin ku të kanë caktuar të ulesh. Të rrih për kraht të panjohurve që të ndodhen pranë, të cilët as të njohin, as të nderojnë dhe as që duan të dinë se kush je. Ata kanë ardhur të shohin teatër.

pranojmë edhe atë që nuk na pëlgen dhe që nuk është e vërtetë: të pranojmë se teatrot antikë nuk i paskemi ndërtuar dhe ruajtur ne, por njerëz të tjerë, që me tjetër ndjeshëri ndaj së bukurisë dhe publike? Ndryshe si ta shpjegojmë sjelljen tonë të vrshëzë ndaj çdo gjëje që ndërtojmë vetë dhe që është ngurit mbi truallin tonë në 2000 vjet, pa dallim nëse është urë e lashtë, kishë e hershme, shtëpi e moçme, mal i shenjtëruar, ulli i vjetër apo teatër?

Kush i ndërtoi dhe me çfarë fondesh u ndërtuan institucionet shqiptare të kulturës gjatë shekullit që shkoi? Po të bëjmë një shëtitje në arkitekturën tyre do të shohim se donatorët janë Italia fashiste fillimisht, më pas jugosllavët, rusët, kinezët, Italia e Romano Prodi-t, fondet e Bashkimit Europian, ambasada franceze, amerikane, fondacionet ndërkombëtare më së fundi propozohet iniciativa private. Prej kësaj do të më pëlqente që qeveritë shqiptare, ajo e sotmja dhe të tjerat që do vijnë, të dalin nga tipologjia historike e lëmoshës dhe e pritjes së ndihmës shpëtimtare që mëkëmb Shqipërinë.

Do të doja që shteti shqiptar, së paku kur shtrohet çështja të institucionet e kujtesës, trashëgimisë dhe të ndërgjegjes kombëtare, të ishte i mosvarur, zot në qeverisjen e tij dhe, me zotësinë që i takon ta ketë një shtet mbi 100 vjeçar, ta gjente krenarinë duke marrë mbi vete dhe duke i ndërtuar vetë dhe jo me fonde të tjera veç atyre të buxhetit shtetëror institucionet kulturore me ndikim dhe rëndësi të veçantë. Thënë ndryshe teatri kombëtar duhet të ndërtohet me fondet që shtetasit shqiptarë paguajnë për ta pasur fuqplotë dhe dinjitar shtetin e tij. Te kjo mënyrë mund të gjeja një arsye të brishtë për të vazhduar të besojmë se kushdo që qeveris sot apo që do të vijë më pas në pushtet, nuk do e ketë të lehtë t'i rrenojë, sidomos pa kundërshti, institucionet e kulturës që kur bien, dëshmojnë jo shembjen e tyre, por rënien tonë.

Botuar e plotë në revistën *Poeteka*, 7 Korrik, 2018

F

FESTIVALI

NGA BEN ANDONI

Kërcënimi mediatic, lufta kibernetike, fake news, bota e madhe dhe e frikshme e mediave online, virtualiteti janë disa nga temat që ndërthuren këtë vit në Festivalin Ndërkombëtar të Tiranës, që njihet me akronimet IHRFFA.

Festivali Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut (IHRFFA), që kap edicionin e tij të trembëdhjetë në këtë vit, vjen i organizuar si zakonisht në muajin shtator. Aktiviteti mban si realizues Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi" dhe ka si temë kryesore të shënjuar "Threat to truth" ("Kërcënimi ndaj së vërtetës"). Në të vërtetë, ky aktivitet që e ka vendosur Tiranën për çdo vit në një hartë të rëndësishme kontinentale të veprimtarive filmike kryesisht ato që lidhen me të drejtat e njeriut, ka fituar një prestigj të admirueshëm. Vazhdimësia e bën këtë aktivitet jo thjesht të respektuar por edhe të shumëpritur. Është pikërisht, kjo vazhdimësi e Festivalit të Akademisë së Filmit "Marubi", që e bën të mirëpritur dhe të marrë vlerësimet. Por, mbi të gjitha organizatorët dinë të sjellin dhe filma me renome ndërkombëtare dhe të përgjegjdhura me shumë kujdes. Që do të thotë pjesëmarrësit kanë pasur pjesëmarrje në festivale ndërkombëtare dhe madje mbajnë autorësi personazhesh realisht të vlerësuar Fryt i kësaj është që Festivali ka pothuaj të njëjtët bashkëpunorë të cilët respektojnë dhe mundësojnë vazhdueshmërinë e këtij aktiviteti.

Drejtori i Akademisë "Marubi" Kujtim Çashku, regjisor i njohur, ideator i këtij festivali që e ka krijuar por edhe që mban lart standardet e tij ka menduar që IHRFFA të jetë një nga aktivitetet e duhura për kryeqytetin dhe vazhdimisht t'i përgjigjet trendeve botërore.

"Kërcënimi ndaj të vërtetës", ashtu si mund të merret me mend lidhet me median online dhe fuqinë e pamat që ka marrë bota mediatiqe për fatet e botës së sotme. Tema e portave, manipulimi që i bëhet medias dhe përmes saj të gjitha ndikimeve të sotme dhe mbi të gjitha fuqinë që kontrollon ato, do jetë lajtmotivi i disa prej tematikave të filmave që do t'i projektohen festivalit.

Zakonisht përgjegjdhja ka filluar muaj të tërë para shtatorit dhe për shkak të rëndësisë që ka marrë ky aktivitet në Tiranë, mendohet që ai ta rrokë sa më mirë temën e përgjithshme, që në këtë vit do hedhë dritë mbi problematikat që lidhen me informacionin virtual, por edhe të gjitha ato që po kërcënohen nga aktiviteti i kësaj lloje medie, që ndërthuret shumë me rrjetet sociale

Festivali Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut (IHRFFA), që kap edicionin e tij të trembëdhjetë rresht këtë vit, vjen i organizuar si zakonisht në muajin shtator. Aktiviteti mban si realizues Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi" dhe ka si temë kryesore të shënjuar "Threat to truth" ("Kërcënimi ndaj së vërtetës"). Në të vërtetë, për çdo vit, ky aktivitet që e ka vendosur Tiranën në një hartë të rëndësishme kontinentale të veprimtarive filmike, kryesisht ato që lidhen me të drejtat e njeriut, ka fituar një prestigj të admirueshëm...

Kërcënimi ndaj së vërtetës (Threat to truth)



dhe që ka ndikuar jashtëzakonisht në aspektet e ndryshme sa i përket të drejtave të njeriut.

Merita e organizatorëve është se problematikat janë të kuruara me kujdes përmes emrave të përgjegjdhur dhe t'i ke pasqyrimin në një rang gati botëror. Publiku mund të kundërojë rroket e temave, kurse profesionistët kanë mundësinë më të mirë të shikojnë edhe trendet teknike në art. Ashtu si ka vepruar dhe në edicionet e tjera përpjekja bëhet që publiku elitat dhe jo vetëm të shikojë trendet në art sesi i trajtojnë vetë tematikat.

Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri është një aktivitet që aspektin kulturor e ndërlihd natyrshëm me të drejtat e njeriut. Kjo, pasi të gjitha atributet e festivalit, që lidhen përveç projektive edhe me ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat e njeriut, bëhet nëpërmjet imazhit filmik dhe krijimtarisë artistike.

Aktiviteti realizohet gjithë nga viti 2006 dhe Akademia e Filmit dhe Multimedias MARUBI e organizon Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (IHRFFA), në bashkëpunim të ngushtë me një rrjet të gjerë institucionesh dhe organizatash vendase dhe të huaja, aktive në fushën e të drejtave të njeriut. Dhe, ashtu si mund të merret me mend, partnerë të tillë seriozë janë gjithnjë të pranishëm si: UNICEF, Austrian Cooperation, OSCE, Instituti Shqiptar i Medias, Delegacioni Europian, Fondacioni Friedrich Ebert, Instituti Italian i Kulturës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Ambasada Franceze, Gjermane, Amerikane, Austriake, Hollandeze, Utica College, por edhe Ministria e Kulturës etj.

Disa nga filmat që do të projektohen

THE SHADOW WORLD

Andrew Feinstein në filmin e tij "The Shadow World" heq perden dhe na tregon paradoksin e tregut masiv ndërkombëtar të armëve. Zbulon korrupsionin dhe atë që ndodh pas marrëveshjes më të madhe në histori për armët mes qeverisë Britanike dhe asaj Saudite – për transakcionet e BAE-s në Afrikën e Jugut, Tanzani, Evropën Lindore dhe kompleksitetin e lidhjes që vjen nga Kongresi Amerikan me biznesin e armëve. Ai zbulon detaje të tregtisë së armëve. Nga ana tjetër, filmi na zbulon edhe rrezikonin e madh të këtij rrjeti që na përfaqëson dhe që përballet me lajmin mediatic.

"IUVENTA" KTHEN LAMPEDUSËN NË FILMIN E MICHELE CINQUE

Ka kaluar gati një vit që kur anija e organizatës së shoqërisë civile gjermane "Jugend Rettet" hyri në portin e Lampeduzës, shoqëruar nga dy anije patrullimi të rojes bregdetare. Iuventa është anija e parë e organizatës joqeveritare që do të konfiskohet. Michele Cinque që e ka realizuar filmin, ka marrë vlerësimet të jashtëzakonshme për këtë histori.

"Rinia që shpëton". Ky është kuptimi i togfjalëshit "Jugend Rettet", OJQ e themeluar në vitin 2016 në Berlin nga një grup i rinjve me një qëllim: të kundërojë në ujërat e hapura me anijet e Iuventës, për të shpëtuar ata që largohen nga Afrika në Evropë.

Ëndrra e tyre nuk është aq e lehtë për t'u përmbushur: pavarësisht nga fisnikëria e projektit të tyre, utopia e të rinjve duhet të përballet me realitetin e vështirë, plot me deklarime politikanësh që nuk

duan të ndihmojnë Mesdheun. Michele Cinque tregon pikat e mosinteresimit të medias dhe institucioneve evropiane dhe planin e tyre për emergjencat humanitare. Iuventa tregon një rrugë të vështirë, që lidhet me ligjet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për të cilat njeriu është e pamundur të mbetet indiferent. Përgjatë një viti të operacioneve në Mesdhe kjo OJQ shpëtoi më shumë se 15.000 njerëz. "Iuventa" është prodhuar nga Film Lazy me RAI Cinema, në bashkëpunim me ZDF-në.

"THE TRIAL" (GJYQI) I ASKOLD KUROV

Në vitin 2015, Askold Kurov ishte një nga vëzhguesit më seriozë të gjyqit të dy banorëve të Krimesë - regjisorit Oleg Sentsov dhe Aleksandër Kolçenko - të cilët u dënuan me akuzat terroriste respektivisht me dënime 20 dhe 10-vjeçare. "Gjyqi", i cili e ndjek çështjen e Sentsov qysh në gjenezë, u shfaq fillimisht në Festivalin e Filmit të Berlinit në 2017, dhe shfaqjet e tij u shndërruan në ngjarje publike në mbështetje të lirisë të regjisorit ukrainas dhe të burgosurve të tjerë politikë të këtij vendi. Kamera tregon një sallë gjyqi në Rostov-mbi-Don, ku një njeri filmohet pas shufrave të kafazit të tij, sytë i zbulojnë gjendjen ku nervat janë gati të shpërthejnë. Sot atij do t'i jepet një dënim për të cilin ai duhet të vuajë 20 vjet burg në Siberi për terrorizëm. Njeriu është Oleg Sentsov, një drejtor filmi dhe aktivist i Maidanit i lindur në Simferopol në Ukrainë. Ai është akuzuar për udhëheqjen e një lëvizje terroriste anti-ruze dhe sipas tyre ka planifikuar sulme ndaj urave, linjave të energjisë dhe një monument të Leninit.

"KURRIZI" E ORGESA ARIFIT, STREHA E SHOQËRISË ELITARE NË VITET '90-ta

Ky film tregon një pjesë të shoqërisë urbane të Kosovës të viteve 90-të, ku shpërfaqen elementet e ndryshëm të rinjve... Kamera zbulon kafe të njohura të atyre viteve, ku rrinin shqiptarët e serbët, por edhe shumë personazhe të njohura publike të cilët kishin lindur e ishin rritur në atë pjesë. Në atë kohë, shumë të rinj e gjenin veten vetëm në atë pjesë të qytetit dhe e identifikonin shoqërinë me të. Ai identifikohet me epitetin "Kurrizi" dhe ishte një pjesë e Prishtinës, e cila mblidhte historinë e të rinjve kosovarë që po bëheshin gati të shpërthejnë.

"Në teatër e në kinema nuk kishim 'guxim' të shkonim sepse këto institucione udhëhëqeshin nga serbët dhe shumë thjesht e ndjenim vetën të huaj. Kurrizi ishte ajo pjesë që ndiheshim rehat", thotë në dokumentarë politikani Albin Kurti, sot lider i Vetëvendosjes.

HANK LEVINE/ FILMI EXODUS

Ky film i kushtohet njerëzve si refugjatë dhe azilkerkues në shumë vende geografike si Gjermania, Brazili, Sahara Perëndimore, Myanmar, Kuba, Sudani i Jugut, të gjithë në kërkim të të drejtave të tyre, p-orë dhe për një jetë më të mirë.



P POEZIA

Autori shquhet për një poezi me një mendim të gjerë dhe figuracion të pasur; që i shërben idesë së tij. Edhe format që shpërfaq për poezinë e tij e tregojnë me shumë pretendime në artin e vet...

Rekuiem i gruas prej letre



NGA PETRAQ RISTO

Ankimi i Luciferit (fragmente)

Ndonjëherë të shohësh brenda vetes si të shohësh pasqyrimin në pusin e errët
 Aje poshtë ku drila lëngon nga plagët e viteve
 Dhe qielli shkon e vjen si tekati e një gruaje të ndezur.
 I etur të shohësh brenda teje, të hedhësh kovën në thellesi
 Aje ku uji përzier me pak kurth reje, pret të biesh edhe ti.
 Kërcet çikriku, litarit me kujtesë varmihesë bren buzët e pusit
 Siç gdhënd i burgosuri ditët, javët, vitet, në murin e tij
 Bie kovë në pus dhe plagët e ujit të lusin: na pi, na pi!...

Kam qenë engjill me flatra blu, jam hije me bërtamë drite
 Shpesh zgjohem në sytë e tu, shpesh në gjakun tënd vritem.
 Ringjallet, përsëritem... Si drila nga ferri ulëritem...
 Në një det squfuri, në vorbull ankimesh: vërtitem.
 Zverdhën parabolat e gjithçka është themë për mua
 S'është e vërtete që me kthetra i kam duart
 Me projektoret e birëve qiejt kam ndriçuar
 Kush vdes në muzgon e syve, në gjak ka për të aguar...

Pse tre?... Po sa?.. (Fragment)

Kam një lot ta ndajë në tre pjesë
 Pse tre?... Po sa?..
 Unë them në pesë
 Se loti i njeimet s'kthehet dot në vesë.

Pse pesë? Po sa?..
 Unë them në kater
 Një lot dhe pse lëng, di zjarrin ta ndezë
 Dhe zemrën ta kthejë në valër...

Pse katër, po sa..
 Unë them në dy
 Një zjar për mua, një zjarr për ty.

Pse dy? Po sa?..
 Unë them në gjashtë
 Shiko sa sy na presin jashtë
 Loti na ndan, loti na bënë bashkë
 E magjeps natën, e kthen nusepashkë.

Pse gjashtë? Po sa?..
 Unë them në tre
 Gjithnjë brenda lotit fle një rufe
 Dhe kur jemi dy
 Gjithnjë ka një tre...

O Zot, brenda lotit zgjove një rufet

Pse tre? Po sa?..
 Unë them vetëm dy
 I tretë të tretet si ylli në sy

Rokulliset loti... bëhet Perëndi...

Pse dy? Po sa?..
 Unë them në tele
 Vetëm tele dallgë mund ta bëjnë një det

Pse tele po sa?
 Unë them tele një
 Pret një fshat i tërë
 Që dasma të vijë...

Vetëm një pik loti
 Ortekun ta shkrisë.

Jo letëmjë, po sa?..
 Unë them një milion
 Një oytel i tërë
 Lotin ka ikonë...

Dhe dy dhe tre dhe katër dhe pesë
 Dhe gjashtë dhe tele
 Rokulliset loti e na sjellë tërmet
 Tele dallgë shpirti s'e bëjnë dot një det
 Veç një pikëz loti s'e shkrin një ortek
 Ah, gisht i unazës kthehet në direk
 Velloja e artë: veteze në breg
 Dhe loti në faqe: busull e vërtete...

Këtu bie shi...

Sa herë ti ikën këtu bie shi
 në çatinë e zemrës gjithnjë bie shi
 nuk e kthen kokën në sy breron shi
 në kopshin e vogël lulezën habi
 këtu bie shi, bie shi, bie shi...

Një shenjë nga larg: këtu vetëlin
 Ca fjalë nga larg – këtu bie shi
 Troket në prag, kudo bie shi
 Petalelagur çdo lule shpik magji
 këtu bie shi, bie shi, bie shi...

Dal në rrugë dhe pse bie shi
 hyj në klub ku mungon veç ti
 një kitarë shkëlqimdashuri
 dikush në saks në notat në orgji
 jashtë bie shi, bie shi, bie shi...

Hesh në banak, porosis dhe pi
 Ca kujtime-flakë më ngrohin gjithsesi
 në pistën henake – valëzues të rinj...
 -Silina kamarier dy gota me shi
 Me të kuqe vere t'i ngjyjet tanit!..
 Jashhtë bie shi, bie shi, bie shi...

Rekuiem i gruas prej letre

Kur të jesh vetëm me një grua prej letre mbi tryezë
 Një filxhan kafe, një ëhisky dhe një klerik në sherbesë
 Kur të jesh vetëm me velen pa fiksimë velvrasjeje
 Guxo dhe mbill një mollë me farezat në formën e lotëve
 Dhe ca zogji po prej letre që nuk zgjedhnojnë dot foljen "ngasje"
 Dhe ca avionë prej letre në intineraret e zemrave-aeroporte.

Në dasmen tënde gjashtë lotë mbolle, gjashtë lotë të vegjël:
 berthameza molle
 Gjashtë bisqe çelën, hutuan të dielen: e gëzofsh, o dhëndërr,

nusen që solle!

Bëje gruan prej letre të flasë: nën hijen e mollëve nuk mund të të vrase
 Dhe zogjtë prej letre uli në degën e mollës
 Në zemrën tënde (fatkeqësisht prej letre) të zbresin mesazhe në formë avionësh.
 Pij kafën, pi whisky (një, dy, tre...) ktheje gjithë shishen të them!
 Një det i madh me rreshta dallgësh: vargje në jerm
 Lulu me sy nga qielli dhe nga kleriku (mbase prej letre)
 Merru me gruan prej letre,
 fall një shtraz prej druri (nga do lind një foshnjë prej letre)
 dhe në fund: arkivoli prej druri në formën e një libri prej letre.

Në vdekjen e saj gjashtë lotë mbolle, gjashtë lotë të vegjël:
 berthameza molle
 Gjashtë bisqe çelën, hutuan të dielen: gjithë varret e ndjenë
 dhembjen që solle.

Mësuesja e historisë vetvritet...

E gjelen në rënojat e qytetërimeve të vjetra me lulekuqe në lëtmë
 Me buzëqeshje cinike në gojën e hapur ku vërtitej një blete e hutuar.
 Fotografitë bënë xhiron e botës: Mësuesja e vjetër e historisë
 Me pistoletën e vogël në duar... Trupi ftohet shpejt.
 Në rënoja qytetërimesh gjaku avulluar....

Renden femijet, nipërit, mbesat, renden nxënësit e mësuesit
 me avionë, me trena, me makina, duke vrapuar...
 Në fotot e gazetave Mësuesja e Historisë: në gojën e hapur një
 blete e hutuar...
 E hutuar?! Po pse e hutuar? Çdo një blete në një gojë pa jetë...
 Mësuesja e vjetër e historisë me një pistoletë.

Shfleuan leksionet dhe ditaret e saj
 "Çdo ditë Toka vetëshpallet, zhvishet nga albitë, përsos mjetet e torturës
 Ndjën vhidhisen e boshtit të vet, i ankohet Diellit për dritën e ndryshkur
 Lutet për shpikjet e reja për vdekje të shpejt nën sindromin e ertësirës.
 Toka e lodhur me bimësi të përcudnuar, me sy të perënduar nga narkozja
 Endërron ditë që s'vijnë, risheh braklisjen e perëndive paraapokaliptike
 Toka, Toka vetëshpall mplakjen me gjinjtë e vyshkur të piramidave.
 Piramida në shkretëtira, Piramida në Bosnje, Piramida mes akujve
 Piramida nën Trekëndshin e Bermudës...
 Gjithë globi mbjellë me Piramida dhe unë u mësoj historinë e gënjeshtrët
 Per njeriun, dinosaurët dhe mamuthët...
 Toka e lodhur endërron vesën e muajit maj dhe trëndafilin kryqëzuar të yjet.



Ah, vesa e muajit maj e pastër si lotët e perëndive! Ah, vesa e muajit maj!
 Dhe trëndafil dhe vesa dhe blelet dhe fluturat po rrallohen nga pesticidët...
 Dhe unë mësuesja e vjetër s'gjej forca të qaj, s'gjej forca të qaj... "

U mësuaam me urtesinë tënde, shikimin e ngrohtë, lotin e fshehur pas çdo lajmi të hidhur.
 Heshnja pas Luftës mban erë baroti, shpirtit: ditare të grisur
 Një çast janë shtlangur gjendrat e lotit dhe gjendrat e qumështit në sise.
 Dhe zogjtë janë fshehur, zogjtë i zë gjaku, luftrat behen me zogjarralitur.
 Askush nuk flet veç të vrarët syhapur presin qiririn e hënës të ndrisë.
 "Ruani blelet, kujdesuni për blelet
 Nëse blelet zhduken nga Toka e ardhshmja do veshi rroben e zisë!"

Në gojën tënde një blete e hutuar si në një hojë të hidhur.

...

Fërkoj sytë. Mbi vetullën e majtë një zog çukit.
 Eshhtë e hapur dera, mos trokit!..
 Shiu bie tej dritares: në qiell rend dikush tërë frikë.
 Mos trokit. Të marrësh frymë mes ndërës
 Dhe të zgjosh nga gjumi perënditë.
 I bute shiu: mijera këpuçe foshnjesh çelën në rrugice
 Një re e bardhë ylberin vë karficë... Mos trokit!...

U poqën vishnjët...

U poqën vishnjët në pemishte: duken veshja në kishë
 Rrëfihen për ditël e dritëshme: u përkusqjen velet e trishhtë
 U poqën vishnjët në pemishte...

U poqën vishnjët në pemishte: mpiksuar muzgjet çmendurishit
 Shkelqejnë nën vese si sy magjish: mes mrekullish të ulerish
 Blasfemiojnë veshjat në kishë...

Çama mishin...

Çama mishin me thikën prej fildishi, me fildish të hënës çama mishin
 Te agoj nga gjaku unë i trishiti e të mbys trishtimin prej fildishi
 Gjer në kockë të hënës çama mishin, veteza e zemrës të më grshi

Do agoj anije unë i trishiti, do lundroj në dallgët prej fildishi
 Me një thikë hënë çama mishin, të zgjoj ca pulebardha prej fildishi
 Në një kryq direku të gjej Krishtin, gjakun verë në kupeze fildishi
 Me një hënë të njomë çama mishin, shpirti-erë: anija prej fildishi
 Mishin, moj, hapma me një thike, pik-pik të pikoj fildishi
 Jam një shpirt i lirë e do të ik, do agoj një foshnjëzë prej mishi
 Dhe nëse të të vetëm mos ki frikë: do të bëhem thikë prej fildishi...

E çmendura

Mjekët bluzabardhë me shenjat e elektroskokut në vend të rrudhave
 mbledhin supet kur flasin për ty
 Ku je gërshetadardhur mbi supe magjije, me një det të kthjellët
 mbledhur hajmail.

Ma jep gërshelin ta pres, hajmailnë e detit më fal
 Ku je e çmendura e parrezikshme, e vdekura pa funeral.
 Ku je?... Mbjaj mend një tren që rend dhe ti që rend para trenit
 (i ngjashëm ky imazh me flakën e gërshetit).

Pastaj fizamnika në një mbrëmje buzëdetit
 dhe guaskat që i bërë velth
 dhe laureshat që vdekjen presin
 pëmbi kurmin tënd.

Ku je e çmendura e mençur, jetimja me një ëndërr fejuar,
 loti i vonuar që bie heshtur

nga syri i dikujt
 që ka tre orë pushkatuar.
 Thojë se të ndiqnin hijet, policët. Një revolver i arte
 rrinte fshehur në gonxhe jargavani. Pasqyrat
 të benin shenja me çdo të plasaritur,
 gjyshi të dërgonte degez ulliri me sqepin e një pelikani...
 Ku je tragjedi e lodhur, Kasandër e vrarë, Andromakë e marrosur,
 Loti i vonuar që bie heshtur
 nga fytyra e ëngjellit prej vitesh vrarë.

L LETËRSIA

NGA CARVEL COLLINS

SKENA: Studioja e Z. Simenon në shtëpinë e tij të bardhë disi të hallakatur në një zgrip të Lakeville, Connecticut, fill pas drekës në një ditë janari plot diell të shkëlqyeshëm. Dhoma reflekton pak a shumë pranarin e saj: E gëzueshme, praktike, mikpritëse, por krejtësisht e kontrolluar. Në raftet e tij gjenden librat e ligjit dhe mjekësisë, dy fusha në të cilën ai është ushtruar si një ekspert të vërtetë; doracakët e telefonit nga shumë pjesë të botës prej të cilave ai nisët në emërimin e karaktereve të tij; harta e një qyteti ku ai sapo është vendosur për romanin e tij të dyzetë e nëntë me personazhin e vet Maigret; dhe kalendari në të cilin ai ka shënuar me një X, fiksuar me një shkumës të rëndë ditët që kaloi duke shkruar Maigret-një ditë për një kapitull dhe tre ditë për ta rishikuar atë, një punë të cilën ai e ka ndërprerë dashmirësisht vetëm për këtë intervistë.

Në zyrën fqinje, duke parë se asgjë nuk ishte rregulluar ende në mënyrë e duhur për bashkëshortin e saj dhe intervistuesin, Madamë Simenon shmanget. Ajo e ka kthyer kujdesin e saj në punët e biznesit të shkrimtarit, romanet e të cilat dalin gati gjatë në vit dhe kontratat e të cilat për libra, adaptime dhe përkthime janë njëkohësisht në më shumë se njëzetë gjuhë të ndryshme.

Me një kortezi të madhe dhe me një zë të pasur, që u jep deklaratave të tij kuptimin përtej rendit të zakonshëm, Z. Simenon e vazhdon diskutimin e filluar qysh në dhomën e ngrënies.

Simenon: Vetëm një copëz këshille e përgjithshme, që është dhënë nga një shkrimtar, ka qenë gjithmonë e përdorshme për mua. Këtë e pata nga Colette. Isha duke shkruar tregime të shkurtra për *La Matin* dhe Colette ishte atje redaktoria e letërsisë, në atë kohë. Kujtoj se i dhashë dy tregime të shkurtra dhe ajo mi ktheu, kështu që u përpoqa sërisht dhe sërisht. Përfundimisht, ajo më tha "Shiko janë shumë letrare, gjithmonë e më shumë letrare". Ndaj e vazhdova për gjithë kohën këshillën e saj. Kjo është ajo që bëj kur shkruaj, puna kryesore kur dua të rishikruaj.

Çfarë doni të më thoni me "shumë letrare"? Çfarë prisni aty, ndoshta përcaktim të vërteta në morfologji?

"Mbiemra, ndajfolje dhe çdo fjalë, e cila do ishte atje vetëm për të krijuar një efekt tjetër. Çdo fjalë, e cila është atje, por vetëm për një fjalë. Ju e dini, që keni një fjalë të mrekullueshme-të prerë. Në çdo kohë, unë gjej një të tillë në ndonjë nga romanet e mia që është bërë për t'u prerë".

Është kjo natyra e pjesës më të madhe të rishikimeve tuaja?

"Pothuajse e gjitha vjen nga ky proces".

Nuk është thjesht një rishikim i modit të fabulës?

"Oh, unë s'pres kurrë ndonjë gjë të këtij lloji. Ngandongjëherë, kam ndryshuar thjesht emrat ndërsa shkruaj; një grua do të jetë Helen në kapitullin e parë dhe Charlotte në të dytin, ju e dini më mirë këtë; kështu që në rishikimin tjetër - e kam sqaruar drejt deri në fund. Dhe, pastaj, prerje, prerje dhe prerje...".

A ka në këtë proces ndonjë gjë tjetër, që

Kjo është një pjesë e shkrimtarit të njohur belg, krijuesit të dedektivit të famshëm Maigret. I qartë në atë që thotë, ai duket se ka një stil pune që tregon realisht edhe pse është kaq prodhimtar. Pranon se ka bërë edhe shumë romane komerciale, edhe pse këtu do të flasë vetëm sesi punon zakonisht romanin e tij: Në pragun e ditës së parë, unë e di mirë se çfarë do të ndodhë në kapitullin e parë. Atëherë, ditë pas dite, kapitull pas kapitulli, unë e gjej atë që do të vijë më pas.

Georges Simenon

Të shkruarit është prirje e pakënaqësisë... dhe jo profesion

ju mund t'ua thoni shkrimtarëve fillestarë?

"Të shkruarit është konsideruar si një profesion, por unë s'mendoj se është thjesht një profesion. Mendoj se çdokush që nuk ka nevojë të jetë shkrimtar, apo që mendon se mund të bëj diçka tjetër, atëherë duhet të bëj diçka tjetër. Të shkruarit s'është një profesion por thjesht prirje e pakënaqësisë. Nuk mendoj se një artist mund të jetë ndonjëherë i gëzuar".

Pse?

"Sepse, fillimisht, mendoj se nëse një njeri ka nxitjen që të jetë artist, kjo ndodh thjesht sepse ai ka nevojë të gjejë vetveten. Çdo shkrimtar përpigjet të gjejë vetveten përmes karaktereve të tij, apo përmes të gjitha krimeve të tij".

Ai shkruan për vetveten?

"Po. Sigurisht".

A jeni i ndërgjegjshëm se do të ketë lexues për romanin tuaj?

"E di se ka shumë njerëz që kanë pak a shumë të njëjtat probleme që kam unë, me pak a shumë atë intensitet dhe që do jenë të lumtur të lexojnë librin, kjo për të mundur të gjejnë përgjigje-kuptohet nëse përgjigja mundësisht mund të gjendet aty".

Edhe kur autori nuk mund të gjejë përgjigjen që duan lexuesit sepse autori është me plot kuptimin i hallakatur tek ajo?

"Kjo është. Sigurisht. Nuk kujtoj nëse të kam folur ndonjëherë për një ndjenjë që më ka shoqëruar për shumë vjet. Pasi shoqëria është sot pa një religjion të fortë, pa një hierarki të saktë të klasave shoqërore, kurse njerëzit janë të frikësuar nga organizatat e mëdha - në të cilat ata janë thjesht një pjesë e vogël, ku për ta leximi i romaneve të vërteta është pak si të parët përmes vrimës së celësit, ku kjo bëhet për të mësuar se çfarë është duke bërë fqinji dhe çfarë po mendon ai-ndaj them: A ka ai të njëjtin kompleks inferioriteti, të njëjtat vese, të njëjtat tundime? Kjo është ajo se çfarë duan ata në punën e artit. Mendoj se shumë njerëz sot janë të pasigurt dhe janë krejt në kërkim të vetvetes.

Ka tani kaq pak punë në letërsi për sa i përket mënyrës sesi shkruante në kohën e tij Anatole France- për shembull. A e dini që- Ai ishte shumë i qetë dhe elegant dhe njëkohësisht i bindur. Nga ana tjetër, ajo që duan njerëzit sot ka të bëjë me shumë me librat kompleks, që përpigjen të shkojnë drejt çdo skute të natyrës humane. A e kuptoni se çfarë dua të them me këtë?"

Mendoj se po. Ju doni të thoni se kjo nuk ndodh sepse sot në mendojmë se dimë më shumë rreth psikologjisë edhe sepse gjithnjë e më shumë lexues kanë nevojë për këtë lloj fabule?

"Po. Një njeri i zakonshëm që ka mbushur të pesëdhjetat-ka shumë probleme sot, të cilat ne nuk i dimë. Pesëdhjetë vjet të shkuara ai i kishte përgjigjet. Ndoshta s'kishte më shumë se sot".

Një vit të shkruar apo pak kohë më parë, juve dhe unë kemi dëgjuar një kritik që pyeste se romani sot i është kthyer një lloji



të shkruar në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

"Është e pamundur dhe mendoj se është komplet e pamundur. Sepse ne jetojmë në një kohë, kur shkrimtarët nuk kanë gjithmonë barrierat rreth tyre, ata mund të përpigjen që të paraqesin karakteret me shprehjen më të plotë, që u vjen. Ju mund të tregoni dashuri në një histori shumë të këndshme apo dhjetë muajt e parë të dy të dashurve, ashtu si bëhej në letërsinë e kohës së shkuar. Por pastaj, juve do të keni një lloj tjetër historie: ata fillojnë e mërziten; kjo ishte në letërsinë e fundit të shekullit të shkruar. Dhe atëherë, nëse do jeni i lirë të shkoni më tej, njeriu është pesëdhjetë dhe përpigjet të ketë një jetë tjetër, gruaja bëhet më xhelozë dhe ju tashmë keni edhe fëmijët që janë të përzierë në këtë histori; kjo është historia e tretë. Neve jemi në historinë e tretë tani. Nuk mund t'i ndalim kur martohen, nuk mund t'i ndalojmë kur ata fillojnë e shqetësohen, ngaqë ne po shikojmë drejt fundit".

Në lidhje me këtë, unë shpesh dëgjoj njerëz që pyesin rreth dhunës në fikshën-in modern. Jam i gjithi për të, por do doja t'ju pyesja pse shkruani për të.

"Neve jemi mësuar t'i shikojmë njerëzit të drejtuar drejt limiteve të tyre".

Dhe dhuna është e shoqëruar me këtë?

"Pak a shumë. Ne nuk mendojmë më gjatë

për një njeri nga pikëpamja e asaj që bëjnë disa filozofë; sepse për një kohë të gjatë njeriu ka qenë gjithmonë i vëzhguar nga pikëpamja se kishte një Zot dhe se njeriu ishte mbretëri i krijimit. Ne nuk mendojmë më aq shumë në kohën tonë se njeriu është vërtetë mbretëri i krijimit. Ne shikojmë njerëz gati ballë-për-ballë. Disa lexues ende do t'u pëlqente që të lexonin shumë romane, libra që u kanë dhënë atyre një pamje komforte të humanizmit. Nuk mund të bëhet më mirë".

Atëherë nëse lexuesit, ju interesojnë, kjo ndodh thjesht sepse ata duan një roman për t'i provuar shqetësimet e tyre? Roli juaj është për të parë gjithmonë tek vetvetja-

"Kjo është. Por s'është thjesht një çështje e vëzhgimit së artistit brenda vetes por gjithashtu edhe e këqijës drejt të tjerëve, vetëm se me eksperiencën që ai ka nga vetja. Ai shkruan me simpati sepse ndjen se njerëzit e tjerë po e pëlqejnë atë".

Nëse nuk do të kishte lexues do të shkruanit ende?

"Sigurisht. Kur fillova të shkruaj, s'e kisha idenë që librat e mi do të shiteshin. Më qartësisht, kur fillova të shkruaj bëja pjesën komerciale-histori për revista dhe gjëra të atij lloji-që të fitoja jetesën time, por s'e quaja atë të shkruar. Por për veten time, për çdo mbremje, unë bëja disa shkrime pa ndonjë ide se ato do të botoheshin ndonjëherë".

Ju ndoshta keni pasur aq shumë eksperiencë sa çdokush tjetër në botë për të bërë atë që ju e keni quajtur shkrim komercial. Cila është diferenca ndërmjet tij dhe asaj që është jo-komerciale?

"E quaj 'komerciale' çdo punë, jo vetëm në letërsi por edhe në muzikë dhe pikturë dhe skulpturë-çdo art-atë që është bërë për njëfarë publiku ose për një lloj të vërtetë të publikut ose për ndonjë koleksion të veçantë. Natyrisht, në shkrimin komercial ka nivele të ndryshme. Ju mund të keni gjërat që janë shumë të lira dhe disa shumë të mira. Librat e muajit, për shembull, janë shkrime komerciale; por disa prej tyre janë bërë në fakt gati në mënyrë perfekte, dhe ngajmë me punë të vërteta arti. Jo komplet, por gati. Dhe në të njëjtën gjë por me copa të vërteta revistash; disa prej tyre janë krejt të mrekullueshme. Por shumë rrallë mund të jenë punë arti, sepse një punë arti nuk mund të bëhet për qëllimin e kënaqësisë thjesht të një grupi të vërtetë lexuesish".

Përktheu Ben Andoni

R

REVIEW

NGA RUDOLF MARKU

1. "Internimi i Kufomës.. është vepra e një autori të panjohur për lexuesin e gjerë (të paktën deri para pak vitesh më parë). I panjohur, në kuptimin e përjashtimit nga aty mekanizmi mediatic që do të na imponojë emra dhe vepra të shënjestruara prej kritikëve a studiuesve a botuesve që duan t'u japin trajtë shijve tona dhe hierarkisë së vlerave. Emrin e Marçel Hilës e kam ndeshur rastësisht veç një herë të vetme në një shkrim të poetes së talentuar dhe dashamirëse Mimoza Ahmeti, e cila ka dëshmuar dhe më parë se vëmendjen e saj e tërheqin veprat me vlera ende të pakurorëzuar prej kumorave të kritikës a të shtypit të përditshëm.

Vetë autori e quan veprën 'Roman'. Në të vërtetë, unë do preferoja ta quaja Histori Letrare, ashtu siç e mendojnë postmodernistët trajtimin e Historisë si atë formë të letërsisë, ku shkrimi i bukur letrar përfshihet natyrshëm në legjitimitetin e praktikës historike. Sidomos pas viteve '70 të Shekullit të kaluar, në Historiografinë serioze filluan të shfaqen ca vepra në të cilat zhargonet e fosilizuara sociale dhe historike u zëvendësuan me shkrimësinë e bukur dhe elegante të narratives. Si shembull i kësaj Historiografie mund të merren veprat e Simon Schama-s në Anglinë e ditëve të sotme : "Qytetarë. Një kronikë e Revolucionit Francez.., dhe vepra e Orlando Figes "Një tragjedi popullore : Revolucionin Rus 1891-1921...". Që nga botimi i këtyre dy veprave prestigjioze, në Historiografi, si të thuash, u legjitimua dhe një formë tjetër e shkrimit të historisë : në vend të trajtimit të temave të mëdha tradicionale të historisë, Historianë ë ndryshëm preferojnë të shkruajnë rreth incidenteve personale, njëloj, të individëve të famshëm dhe individëve aspak të njohur. Si të thuash, tërësia historike tregohet përmes *samples*, përmes grimcave të vogla, të cilat sillen brenda narativës së gjerë historike... Librat "Kthimi i Martin Guerre,, i Natalie Zemon Davis dhe "Masakra e madhe e maces,, e Robert Darrton na e tregojnë historinë përmes narratives së njerëzve a ngjarjeve të panjohura dhe të errëta, në vend të njerëzve a ngjarjeve të famshëm e të njohur.

Vepra e Marçel Hilës është një veper që përfshihet në këtë kategori të Historiografisë moderne.

2. Vepra e Marçel Hilës na tregon historinë e vërtetë prekëse të një familjeje shqiptare menjëherë pas instalimit të komunistëve në Pushkët : ditën që i vdes njëri nga të dy djemtë, familja fatkeq merr urdhrin e internimit. Vila e familjes, që fatalisht ndodhet në atë zonë që do quhej më vonë Bllok, është lakmuar që t'i jepet shefit të sigurimit të Gardës, një vrasësi që aktualisht ende jontone në Brataj të Labërisë. Fati i familjes që internohet së bashku me kufomën e pavarrosur, ngase dhe djali i vdekur është i përfshirë në listën e internimit, dhe kësajsoj nuk ka të drejtë që të varroset në Tiranë, dhe fati i vrasësit profesionist nga Brataj, që i duhet të udhëtojë urgjentisht në Tiranë së bashku me familjen e vet, për të marrë detyrën e re dhe Vilën e re në Tiranë, ndërthuren herë tragjikisht dhe herë në mënyrë groteske, përmes vizatimit me mjeshtrit të karaktereve të shumtë, që nga Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Muço Mevlanaj dhe, nga ana tjetër, Zoi Xoxa, Eleni, Kostaqi dhe Muzaka, një regjistër që i mjaftueshëm për të na dhënë tmerrin e Komunizmit shqiptar. Një historiograf skrupuloz do të më kujtonte fjalët e Robert Finlay-t që "historiani nuk duhet t'i bëj njerëzit e së shkuarës që të thonë a të

Autori na sjell një "review" të një romani pothuaj të panjohur, që tregon kalvarin e një familjeje në regjimin komunist. Autorit i ka bërë përshtypje se autori e ka botuar vetë librin, ndërkohë që autorët rëndom botojnë vetë në vendin tonë. "Është ky realitet që e bën librin e Marçel Hilës një veper me një vlerë të jashtëzakonshme. Nuk është e rastit që ky libër është i vetëbotuar nga autori", shprehet ai... Për të ardhur keq, autori e kish botuar edhe në organ tjetër shkrimin...

NJË VEPRË PËR TË VERTETEN HISTORIKE

("Internimi i Kufomës" - i Marçel Hilës)



bëjnë gjëra që nuk provohen nga faktet a burimet arkivore". Në të vërtetë, Kapitulli i Pestë është një dialog mes Diktatorit dhe Koçi Xoxës. Në zyrën e Diktatorit vendoset dhe fati i Zoit, karakterit qendror të librit. Robert Finlay-t mund t'i përgjigjeshim se portretet dhe dialogët e Diktatorit, përkshkrimi me detaje i fatit të familjes Xoxa, apo grotesku i Muços, i gruas së tij, Lutfijës, apo i nën ë Zyras, skena kur Lutfija për herë të parë do që të blejë një palë këpucë grash në Vlorë, apo ajo mahnitja e përzier me zili, kureshtje të fshehur seksuale dhe me urrejtje, kur Lutfija sheh në sirtarët e shtëpisë për herë të parë në jetën e vet të mbathura grash apo libra (qitape- i quan ajo dhe Muçua) – të gjitha këto janë të ligjshme në të vërtetën e historike, sepse përputhen besnikërisht me çdo gjë që njohim për Diktatorin apo për gruan e fshatrave të Labërisë në ato vende të Shqipërisë së asaj kohe, apo dhe më parë-përkshkrimet të njëjta na japin dhe burimet e mëparshme për gruan e atyre krahinaeve (kam parasysh, p.sh., librin 'Ditari i një Peisazhisti, të poetit dhe piktorit të njohur anglez Eduard Lear, një shekull më parë, shkruar dhe botuar nga koha kur zhvillohen ngjarjet e librit të Marçel Hilës). Jo vetëm kaq, por mendoj se vlera më e madhe e këtij libri është ajo që të jërret mund ta mendojnë si pikën e dobët të këtij libri, raporti i librit me të vërtetën historike. Është një libër ku ndjehet tërheqja e perezistueshme e autorit për të vërtetën historike, aq sa duket se autori i qëndron besnik shkrimtarit Octavio Paz që i atribuonete Sollahehencit forcën e rrëfimit të së vërtetës, tek thoshte se "Në një shekull të mbushur me dëshmi të rreme, një shkrimtar duhet të bëhet dëshmitar i Njeriut !"

Një skenë e paharruar e librit është takimi i Muços me Diktatorin. Ka në këtë skenë diçka nga romani "El señor Presidente", të Asturias a nga "Vjeshta e një Patriarku", të Marquize : harmonia e përjetshme e së keqes, tërheqja deri në skllavëri e Mjeshtrit të Madh të torturave dhe vegles së ti; Muço, ky

vrasës macho, fjalëpak dhe i heshtur, ka gati –gati një tërheqje homoseksuale drejt Diktatorit. Kur Lutfija këmbëngul duke i thënë të shoqit që ai duhet t'i tregojë asaj çdo gjë nga takimi i tij me Diktatorin, ai përgjigjet duke i thënë, si prej një deliri të thellë, se " ai është i bukur, moj, i bukur, si melek (engjell)-njeriu më i bukur që më kanë zënë sitë..... Një skenë që të mbetet në mend për një kohë të gjatë. Por edhe kjo skenë është në harmoni të plotë me të vërtetën historike, sepse gjithçka është në përputhje me tipologjinë e Diktatorit shqiptar dhe të veglave të tij.

Ky libër që vjen si një hirushe e panjohur, modeste, kokulur, pa pretendime hierarkike, e nxjerr padashje të zbuluar keqas një pjesë të mirë të raportit të historiografisë, dhe , pse jo, dhe të letërsisë bashkëkohore shqiptare, me të vërtetën. Nuk është e rastit që librin e vet Marçel Hila guxon ta mbyll me një shqetësim për të vërtetën : "Ai vend (Blloku-shënim i artikullshkruesit)...të afion material për një sagë gjigande, interesante, origjinale dhe prekëse. Letërsia shqipe i detyron një vëmendje të madhe atij skaji. Është e habitshme që letrarët tanë nuk janë kujtuar ende për këtë! Do Zoti dhe zgjoheh një ditë!"

3.

Libri i Marçel Hilës na kujton edhe njëherë se Shqipëria është njëri dy vendet e vetme ish-komuniste që nuk e ka arritur atë që psikiatrit e quajnë Closure. De-stalinizimi i Hrushovit në Rusinë e fundit të viteve 50' të shekullit të kaluar dhe De-enverizimi i Shqipërisë në fundin e viteve '90 dhe në dy dhjetëvjeçarët e Shekullit XXI kanë qenë thjesht manovra politike për t'u ngjitur në pushtet me taktikën e manipulimit të shprehsive popullore- rezultatet e destalinizimit dhe të de-enverizimit janë konsolidimi i mëtejshëm i pushtetit komunist, ruajtja e strukturave të dikurshme, prurja në pushtetin politik dhe në atë ekonomik i fëmijëve të kastave të udhëheqës komunist, përdorimi i leksikut të njëjtë dhe i arrogancës së

njëntj komuniste nga pushtetarët djeshëm e të sotëm, falsifikimi i krimeve , falsifikimi i dosjeve, shpifja ndaj kundërshtarëve politikë dhe futja në grindje e ish të përndjekurve dhe e kundërshtarëve të dikurshëm, për ta diskredituar jo vetëm kundërshtarin e sotëm, por dhe atë të djeshmin. Marçel Hila e përfundon librin duke na njoftuar atë që lexuesit e dijnë me kohë, që Kostaq Xoxa, i cili sot është tetëdhjetë e gjashtë vjeç, nuk ka arritur ta marrë me rrugë ligjore ish-shtetpinë, pronën e vet të ligjshme, Vilën në Bllok, që u pat bërë shkak për tragjedinë e jetës së tij : "Ata që ikën të përzënë prej asaj shtëpie, nuk e fituan më të drejtën mbi të. Ata që hynë, nuk e kanë lëshuar ende..- kjo është një frazë e ftohtë e hedhur diku nga fundi i librit, një frazë që duket e marrë nga një akt-protokoll noterik. Por që të rrëngjeth me të vërtetën e vet. Është ky realitet që e bën librin e Marçel Hilës një veper me një vlerë të jashtëzakonshme. Nuk është e rastit që ky libër është i vetë - botuar nga autori. Asnjë Shtëpi Botuese nuk e ka marrë përsipër botimin e këtij libri. Dhe pothuajse asnjë librari nuk ka pranuar të marrë kopjet e këtij libri për t'ia dhënë lexuesit. Duket se armiqësia ndaj së vërtetës historike është e fuqishme dhe e mirë-organizuar në shoqërimë shqiptarë..

Vitet e fundit tek ne është folur dhe vazhdohet të flitet si kurrë më parë për Historinë. Dhe është e kuptueshme që, në një vend si ky yni, ku Historia, sidomos Historia e kohërave moderne, është konceptuar si një shkencë e politizuar dhe e ideologjizuar deri në palcë, kryetema të jetë pikërisht ajo që ka munguar dhe mungon: e vërteta historike. Jetojmë në një shoqëri ku, siç do të thoshte Historiani i njohur bashkëkohës anglez, zoti Donald Rayfield, e vërteta e së shkuarës është e kycur në arkiva të fshehura, dhe këto arkiva përherë e më tepër na bëhen të pa-arritshme. Edhe ato pak gjëra që ë botohen nga Arkivat, ato janë të para-seleksionura me kujdes dhe të retushuara, po ashtu siç ndodhte gjatë regjimit komunist, që, tek shihje një fotografi arkivore a një dokument, duhej të mendoje për pjesët që ishin prerë me gërshtë. Tekstet shkollore dhe akademike të Historisë, me përjashtime të rralla, i kalojnë në heshtje, ose i artikulojnë me gjysmë zëri, faktet e krimeve të komunizmit. Duket se "Internimi i Kufomës,, është një libër që do të ngul këmbë në, derisa historia të jetë treguar deri në fund, dhe derisa komuniteti botëror të ngul këmbë që legjitimiteti i komunizmit të japë llogari të plotë, Shqipëria dhe vendet e ngjashme si ajo, do të mbesin vende shpirtërisht të sëmura, të ndjekura nga fantazmat e Enver Hoxhës dhe të kasapëve të tij, dhe, ç'është më e keqja, të ndjekur nga ankthi i ringjalljeve së këtyre fantazmave.

Dhe libri i Marçel Hilës është nga ato libra të rrallë që idenë e objektivitetit të Historisë e moderne shqiptare e sheh si një Realitet të së kaluarës, ku e vërteta duhet të korrespondojë me atë Realitet .

Opinioni *i* Ditës

Thaçi dhe Vuçic, çdokush që e lexoi këtë përrallë e ka gabim

Nga Veton Surroi

(vijon nga faqja 1)

1. ... dhjetëvjetëshit dhe më 1999 vendosi që të ndërmerre luftë dhe masa gjenocidi ndaj qytetarëve të Kosovës. Këto masa prodhuan 13.535 njerëz të vrarë, sipas shënimeve të Fondit për të Drejtën Humanitare, prej të cilëve 10 mijë ishin civilë, tre mijë ishin të formacioneve të armatosura. Prej atyre të formacioneve të armatosura mbi dy mijë ishin të UÇK-së dhe FARK-ut, ndërsa një mijë ishin të forcave serbe.

Arsyeja pse Milosheviçi ndërmoi një aksion të këtillë ishte fakti se komunat e Leposaviqit, Zubin-Potokut e Zveçanit kishin mbetur brenda territorit të Kosovës.

Shqiptarët në Kosovë organizuan një lëvizje të padhunshme, të paprecedencë, si përgjigje ndaj okupimit të Serbisë. Në botë do të njihet si rezistenca me "shoqëri paralele", ku tërë një popull injoron dhunën dhe vazhdon në formë rudimentare me jetën e vet sociale. Në fund të dhjetëvjetëshit, një numër të pakënaqurish shqiptarë organizuan rezistencën e armatosur, duke u organizuar në grupe guerile, që do të njiheshin si Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Që të dyja format – ajo e padhunshme dhe ajo e armatosur – nuk arritën që ta mbrojnë popullin e Kosovës dhe shtetet e fuqishme të Perëndimit organizuan një Konferencë paqesje në Rambouillet, në mënyrë që të ndërpritet lufta dhe të gjendet një zgjidhje paqësore për konfliktin. Meqë Serbia refuzoi zgjidhjen e negociuar, shtetet e NATO-s e bombarduan Serbinë deri në tërheqje të okupimit të saj ushtarak dhe policor.

Arsyeja pse shqiptarët në Kosovë organizuan rezistencën e padhunshme e pastaj edhe atë të armatosur ishte se komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje kishin mbetur në territorin e Republikës së Serbisë.

2. Meqë Serbia e okupoi Kosovën për shkak se në të ishin tri komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe, dhe meqë Kosova rezistoi me padëgjueshmëri qytetare e më vonë edhe me armë ndaj okupimit, ngase në Serbi kishin mbetur tri komunat, që dikur kishin pasur shumicë shqiptare. Bashkësia ndërkombëtare u detyrua që, pas ndërhyrjes ushtarake, të vendosë administratë ndërkombëtare në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare investoi më shumë ndihma për kokë banori se në cilindo vend të botës. U kthyen të gjithë refugjatët që u dëbuan, sepse Presheva, Bujanoci dhe Medvegja nuk ishin në Kosovë. U ndërmtuan apo rindërtuan pjesa

Serbia e filloi luftën në Kosovë për shkak të Leposaviqit e Kosova rezistencën paqësore (më vonë edhe luftën) për shkak të Medvegjës



më e madhe e mbi 100 mijë shtëpive të dëmtuara, sepse Presheva, Bujanoci dhe Medvegja nuk ishin në Kosovë.

U ndihmua në ndërtimin e institucioneve të një shteti demokratik, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të vendosin për ardhmërinë e vendit. Nga viti 2005 deri më 2007 u zhvillua një proces i paprecedent negociator, i ndërmjetësuar nga presidenti Ahtisaari, në mënyrë që të përcaktohet statusi përfundimtar i Kosovës. Në fund të procesit Kosova ndërtoi, në bashkëbisedim me forcat politike të qytetarëve të saj që gjenden në pakicë, sistemin më të avancuar për mbrojtjen e minoriteteve në Evropë dhe me përkrahjen e shteteve të Perëndimit u shpall pavarësia e vendit, që u njoh nga mbi njëqind shtete.

Por Leposaviqi, Zubin-Potoku dhe Zveçani mbetën në territor të Kosovës dhe Serbia nuk e njohu pavarësinë e saj. Për më tepër, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja mbetën në Serbi. Kështu, të tria komunat në anët e kundërta të kufirit i lanë të dyja vendet në gjendje të një lufte të papërfunduar.

3.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me seli në Hagë, në korrik të vitit 2010 i dha të drejtë Kosovës për shpalljen e pavarësisë. Kjo pavarësi që shpallur, sipas planit 'Ahtisaari', në kufijtë e Kushtetutës së vitit 1974, pra ato të para okupimit të Serbisë.

Por, meqë këta kufij linin brenda Kosovës Leposaviqin, Zubin-Potokun dhe Zveçanin, e jashtë saj Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, kryeministri i Kosovës dhe ai i Serbisë u pajtuan se vendimi i GJND-së është i pamjaf-tueshëm për Kosovën. Filluan "di-talogun e Brukselit", me ndërmjetësimin evropian, duke u pajtuar që pavarësia e Kosovës mund dhe mund të mos jetë e pranueshme, rrjedhimisht se ashtu e kontestuar dhe e kontestueshme duhet të zëvendësohet me një zgjidhje të re.

Shumë shpejt u dakorduan se Kosova ka nevojë për një autonomi territoriale-politike të serbëve në Kosovë, në formën e Bashkësisë së komunave serbe. Prej vitit 2013 deri më 2018 negociatorët – Thaçi dhe Daçiç/Vuçic – u përpoqën me vullnet të mirë t'u shpëtojnë popullatave të veta se nuk ka zgjidhje më të mirë për Kosovën

sesa një autonomi e këtillë, që do të ishte diçka si Republika Serbe në Bosnjë-Hercegovinë. Por më 2018 që të dyja palët – Thaçi dhe Vuçic, – u pajtuan se edhe po të vendosej autonomia, Leposaviqi, Zubin-Potoku dhe Zveçani do të mbeteshin në Kosovë, kurse Presheva, Bujanoci dhe Medvegja në Serbi. Pra, konflikti do të mbetej i papërfunduar.

4. Në verën e vitit 2018 të dy presidentët më në fund do të gjenin një paketë që do të zgjidhte armiqësitë. Kufiri do të korrigjohet dhe Leposaviqi, Zveçani e Zubin-Potoku do të jenë më në fund në Serbi. Fshatrat e Preshevës së bashku me qytetin deri "te pruga" (te binarët hekurudhor) do të bëheshin pjesë e Kosovës. Autonomia e dakorduar më 2013 do të vendosej në territorin në jug të Ibrit, me seli në Graçanicë. Serbia do ta njihë të drejtën e Kosovës që të jetë pjesë e OKB-së, siç ia ka njohur dikur njëra Gjermani tjetër.

Të dy presidentët do të shpallnin se kjo është një fitore e madhe e paqes. Që të dy do të pajtohen se që një mëkat i madh që një njeriut të madh si Milosheviçi nuk i ka

rënë në mend më herët një paketë e re.

Që të dy presidentët do të ulen menjëherë e të shkruajnë fjalimet, me shpresë se do të lexohen në secënën solemne të cmimit të Nobelit, aty ku janë nominuar nga Federica Mogherini dhe Johannes Hahn.

Që të dy, pa u konsultuar me njëri-tjetrin do të shkruajnë se në fakt lufta nuk do të duhet të kish-te filluar fare: korrigjimi i kufijve ka mundur të bëhet fare lehtë, nga entet e gjeodezisë së të dyja vendeve.

Presidenti i Serbisë do të shkruajë se statusi i Kosovës dhe Metohisë tashmë ka hyrë në rrugë të sigurt të zgjidhjes, në dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjetë e ardhshëm.

Ai i Kosovës do të shënojë se Kosova nuk do të harrojë kurrë dy mijë fëmijët e të miturit të ekzekutuar për shkak se gjeneratatave të mëhershme nuk u kishte rënë në mend se problemi shekullor mes Kosovës e Serbisë ka mundur të zgjidhet shumë lehtë në Medvegje dhe komunat simotra.

5. Çdokush që e lexoi këtë përrallë e ka gabim. Nuk është përrallë.

"Koha Ditore"

Opiniononi *i* Ditës

Dita e Demokracisë, Shqipëria peng i një elite konsensuale korruptive

Nga Afrim Krasniqi

(vijon nga faqja 1)

... nuk është shumë në modë dhe modelet autoritariste dhe populistët po dominojnë ligjërimit politik në shumë prej shteteve demokratike. Me përjashtim të pjesës më të madhe të Evropës, ca vende në kontinentin amerikan dhe ca më pak në Azi dhe ndonjë vend i veçuar në pjesë të tjera të globit, pjesa tjetër e botës është në krizë vlerash përfaqësimi, nën regjime hibride me dominim totalitar, antidemokratik, ushtarak, ideologjik apo refuzues ndaj simbolikës së ditës.

Po Shqipëria? Vendi që rreth tri dekada më parë pati lëvizjen më elitare për ndryshimin e sistemit drejt demokracisë, sot është peng i një elite konsensuale korruptive, marksiste në mentalitet e autoritariste në veprim, të paaftë të ofrojë ndryshime dhe konsensuale në zhbërjen e vlerave demokratike. Tabela e ecurisë së nivelit të demokracisë është zhgënjyese: në vitet 2000 kishte korrupsion, por kishte më shumë demokraci brenda partive politike; kishte abuzim me pushtetin, por kishte më shumë hapësirë konkurruese.

Sot vijon trendi negativ i kufizimit të demokracisë. Dikur adhuronim modelin Thaçer apo Regan, sot adhurojmë modelin Erdogan e Salvini. Krijua parti për të jetësuar pluralizmin dhe sot ato janë shndërruar në bunkerë strehues të 2-3-4-5 emrave riciklues në pushtetet e tranzicionit. Krijua sistem votimi për të pasur konkurrencë dhe sot jemi në kohën e votimit formal, ku kritikut më periferik i ndërpritet karriera politike për një vendim të vetëm të ndryshëm nga shefi. E nisëm me deputetë që vinin nga auditorët dhe arritëm tek ata që na i përzgjedhim nga bota e krimtë. Dikur 140 deputetët deklarorin 180 libra të botuar, sot deklarorin 180 makina luksoze në pronësi. Dëmi më i madh që i bëhet demokracisë nuk është vetëm mohimi i jetësimit të saj, por sundimi antidemokratik duke keqpërdorur termat dhe ligjërimit demokratik dhe duke na e imponuar këtë sundim si model inspirues. Ndaj Shqipëria e sotme, ashtu si ajo e 1990, 1991, 1997, 1999, 2004, 2009 dhe 2013 vijon të jetë vend i ikjes së elitave, i ikjes së brezave më të rinj, i ikjes së atyre që kanë potencial ndryshimi cilësor, – dhe njëherësh, vend ku distanca ndaj pushtetit e qytetarëve është e thellë dhe piramida e vlerave gati e përmbysur.

Cili është debati e elitave sot? Vendi i Shqipërisë në botën dhe rendin e ri botëror, sfidat shqiptare në rajon, rrugëzgjdhjet për ringritje morale apo identiteti i vlerave? Korrektimi i sistemit politik dhe përfaqësues? Rreziku i ndikimeve lindore dhe raportit me Perëndimin? Liritë individuale dhe raportit me ligjin dhe kulturën demokratike? Kriza e arsimimit dhe ndikimi i valëve të emigrimit në të ardhmen?



batutat e ish-kryeministrit, grindjet mes ca çunave të "shkathët" të lagjes që politika i bëri ministra e deputetë, reforma e heqjes së celularëve nga shkolla apo administrata, kazinotë e familjarëve të atyre që bëjnë ligje për kazinotë, gara e kullave në qendër të Tiranës dhe

gara për t'u dukur më pashëm në TV. Kaq. Asnjë më shumë. Asgjë elitare. As reformë dhe as alternativë.

E ardhmja? Ka skenarë të ndryshëm. Duke perfrazuar një mendje librash jo shqiptar, – jeta e një shoqërie, sprovat, potenciali dhe sfidat e saj janë shumë më të gjata e më komplekse se jetët natyrale të çdo individi sado i pushtetshëm qoftë ai dhe se potencialet negative të një brezi sado gabim të jetë ai. A jemi ne brenda këtij përcaktimi? Fëmijët tanë po, me siguri, bashkë me ata pas tyre. Ne, të sotmit, – jo, ashtu si të djeshmit, – sepse në dy rastet kanë/kemi zgjedhur ose pranuar në emër të pragmatizmit të bëhemi bashkëfajtorë, – të heqim dorë nga liritë tona, nga të drejtat tona, nga aspiratat dhe fuqia jonë. Dhe ky mesazh i thotë të gjitha në Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë dhe raportin tallës të Shqipërisë së sotme politike e militante me të.

Cili është debati e elitave sot? Vendi i Shqipërisë në botën dhe rendin e ri botëror, sfidat shqiptare në rajon, rrugëzgjdhjet për ringritje morale apo identiteti i vlerave? Korrektimi i sistemit politik dhe përfaqësues? Rreziku i ndikimeve lindore dhe raportit me Perëndimin? Liritë individuale dhe raportit me ligjin dhe kulturën demokratike? Kriza e arsimimit dhe ndikimi i valëve të emigrimit në të ardhmen?

HOROSKOPI

DASHI

Kohët e fundit doni të bëni gjithçka sipas planit. Mos harroni se jo gjithmonë gjërat ecin në këtë mënyrë, ndaj përpuni të jeni më i shkujdesur në këtë drejtim.

DEMI

Do të kaloni një ditë shumë të këndshme me fëmijët tuaj. Do të kryeni aktivitete të shumëllojshme. Ka gjasë që sot të përfshihen në një lidhje romantike. Ka mundësi që në punë të përballemi me disa probleme.

BINJAKET

Së fundmi jeni ndjerë i stresuar dhe madje herë pas here i dëshpëruar. Mos ndoshta trupi po ju tregon se ka nevojë për pushim? Mësoni të dëgjoni nevojat e fizikut.

GAFORJA

Me kurajë do të mund të kaloni edhe ato momente të vështira që ju dalin në punë. Mbështetja e një personi do të jetë vendimtare.

LUANI

Ka ardhur momenti që të hiqni barrë nga vetja. Mos e lodhni veten me gjëra për të cilat nuk vlerësoheni si duhet. Të tjerët do të nisin të kuptojnë se kush je ti.

VIRGJERESHA

Gjatë kësaj periudhe jvet ju favorizojnë për të gjetur një vend të ri pune. Nëse keni aplikuar, shanset janë që të keni sukses. Në dashuri gjërat janë në vendnumëro.

PESHORJA

Nëse jeni duke planifikuar një udhëtim, mundësitë janë që planet të mos realizohen. Një pengesë mund t'ju dalë papritur dhe t'ju prishë çdo parashikim.

AKREPI

Nëse nuk jeni i bindur për suksesin e një projekti, mos e nisni atë. Yjet nuk ju favorizojnë, veçanërisht në transakcione financiare.

SHIGJETARI

Një lidhje dashurie po nuk ecën me ritmet e duhura. Ndoshta problemet në punë ju pengojnë që të kaloni më shumë me partnerin.

BRICJAPI

Përpara se ta drejtoni gishtin ndaj një mikut apo aleati, përpuni të analizoni të gjitha rrethanat. Nuk është mirë të lëshoni akuza pa fakte.


UJORI

Keni nevojë për ndryshim si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë romantik. Duhet të lëvizni. Mos qëndroni në një vend deri sa këto ndryshime të ndodhin vetë.

PESHQIT

Tregoni shumë kujdes me një çështje ligjore. Nëse nuk e ndiqni nga afër, gjasat janë që të përfshihen në probleme edhe me të mëdha.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Janë vërejtje për veten.
12. Një veprim sulmues.
14. Një verë në Paris.
15. Një pjesë e atributive.
16. Një rrugë në Paris.
17. Fillojnë kallimin.
18. Ekstre në rzik.
20. Në hyrje të oazit
21. Mbyllin një spital.
23. Eshhtë e përpjeta.
24. Kufizojnë një mekanik.
25. Jeton në vetmi.
28. Mund të jenë autonome.
30. Janë diktatorë shtypës.
31. Gjysmë nderim.
32. Janë sekte islamike.
33. Shteti i francezëve.
35. Janë legjenda.
36. Nuk bëhet me lepuj.
37. Jean aktor.

38. Lodh në ekstreme.
39. Inicialet e Duvall.
40. Një gojë vullkani.
42. Morgana e mbretit Artu.
44. Mbarojnë fare.
46. Eshhtë zeshkani.
47. Premtojnë të bëhen asa.
49. Eshhtë Au në tabelë.
50. Ishin mallkime shkishëruese.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktore.
2. Haset pa kufij.
3. Arturo i Brecht.
4. Një sferë për model.
5. Ndezur në aparaturë.
6. Një virtual në computer.
7. Italia në Internet.
8. Një fushë sportive.
9. Kapen të parat.
10. Janë grimcat me bërthama.
11. Eshhtë marrëveshje edhe miqësie.
13. Eshhtë portofol.
17. Janë brinjat në skuadër.
19. Janë të drejtë në skuadër.
22. Shuma e brinjëve të shumëkëndeshit.
23. Një që punon në galeri.
26. Grirë pa kufij.
27. Një metalprerëse si torno.
29. Eshhtë një ushtarak i rangut të ulët.
32. Janë gra të Ankarasë.
34. Ema aktore.
36. Një është edhe Kosova
37. Një Luan në LSI.
38. Altini mesfushor.
41. Kufijtë e rritjes.
42. Një tifoz i rockstar-it
43. Gjysmë aneksi.
45. Ente Tregtare Tiranë.
47. Fillojnë takimin.
48. Inicialet e Mann.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Turk ai i Mozart.
6. Gjysma e sasisë.
9. Qytet termal belg.
12. Një piçe freskuese.
13. Janë edhe ato të forcës.
15. Mund të jetë emërORE.
16. Ngrihen për shkak të epidemive.
17. Rubinstein që qe balerinë.
18. Eshhtë riparimi i përgjithshëm.
19. Në krye të noterëve.
20. Kështu është i mërzitshmi.
21. Carson i fumetti-t.
23. Ushtrohej nag bukanierët.
25. Qendër ditore.
26. Kanë shtretër për derman të tillë.
28. Inicialet e Redford.
30. Emri i Zola.
32. Dickinson që qe poete.
34. Kufizojnë një vend.

VERTIKAL


35. Gjysma e ketrit.
36. Paguhet një për vonesë.
38. Kërkojnë talent të tilla.
40. Eshhtë pjesë e gjuhës.
42. Pesci aktor.
43. Ka mbetur enigmë.
45. Inicialet e Rohmer.
46. Rrjeshtoheshin në legjione dhe kohorta.
47. Hari spiune.
1. Janë trupat e Flotës VI.
2. Jorge shkrimtar.
3. Dino regjisor.
4. Pak stabilitet.
5. Një hektar i shkurtër.
6. Mund të jenë filmi.
7. Eshhtë diletant.
8. Qe arkitekt i famshëm me origjinë shqiptare
9. Bie një me rrebsth.
10. Ishite titulli i Nehru.
11. Ai dhe ajo.
13. Një pallo ushtarake
14. I ka të ndryshme stili.
16. Ndërohen me zapping.
18. Janë këngët me shumë zëra.
20. Si legjendare.
22. Renis që këndonm Quando, quando,quando.
23. Shpimi pa shi.
24. Një mund të jetë deri në dhembë.
27. Almodovar regjisor.
29. Mund të jetë fetar.
31. Eshhtë mundi pa doby.
32. Nuk ka akoma një bebe.
33. Qarkullojnë në Shqipëri.
34. I bytyllit ai i Mjedës.
37. Janë në skaje.
39. Një pjesë e territorit.
40. Fisku pa zë.
41. Eshhtë lloj papagalli.
43. Dymijë romake.
44. Inicialet e Adjani.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4						8			
	3	8				9			2
	7			1			4		
			3			9	5		
7									6
	5	2			4				
	6			7			1		
1			6			4	9		
			1						3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	3	7	5	6	2	9	1	4
5	1	9	8	7	4	6	2	3
6	2	4	3	1	9	5	7	8
9	4	2	1	8	6	3	5	7
3	8	1	7	2	5	4	6	9
7	5	6	4	9	3	1	8	2
1	7	3	6	4	8	2	9	5
2	6	5	9	3	7	8	4	1
4	9	8	2	5	1	7	3	6

Argëtim filozofik

- Njeriu në jetë është shpesh bagazh, të cilin e përdorin të tjerët.
- Më mirë është të njohësh njerëzimin në përgjithësi, se sa njeriun në veçanti.
- Nuk gënjen vetëm ai që flet kundër asaj që di, por edhe ai që flet kundër asaj që nuk di.
- Sa më shumë bëni, aq më shumë mundeni.
- Gjërat e mira nuk vijnë për ata që presin. Gjërat e mira vijnë për ata që ndjekin qëllimet dhe ëndrrat e tyre.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

12	3		10	3	19				P	G	U	S	R	I	K	A	B	D	M	T	E	T	K	
10	4	7	2	12	3	1		10	4	1	3	5	U		E	N	E	I	D	A	P	A	R	A
	12	13	4	1	2	9	2	1	2		6	P	U	K	S	S	N	K	I	A	T			
13		18	3	14	3	10	4	5	3		4	16	A	R	S	H	T	A	T	A	N	I	K	E
3	8		1	1	1		1	4		11	9	2	T		O	P	E	R	A	T	O	R	E	
8	3	9	14	4		1	3	12	3	1	2			M	I	N	E	R	A	L	E	T	I	K
4	7		4		5		7	3	12	11	6	3		B	O	E	R	B	I	T	B	T	U	
15	3	15	1	5	4		4	1	2	3	10	P	A	R	T	I	I	I	N	I	R			
2	10	4		2	16	3	1		5	4	1	4	U	R	I	M	A	S	I	S				
5	2	12		7	4	12		12	3	11		1	L	I	M		E	N	A	O	R	I		
3	16	1	2	12		1	4	14		5	12	4	A	M	E	R	I	K	A	T	U	B	I	M
1	4	2		4	1	2	9	6	7	6	19		T	E	R	R	E	N	E	T	K	A	D	I

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

ARGËTIMI

FILIZOFIKI

KRIPTOSKEMA

PËRGJIGJA E NUMRIT TË DJESHËM

Thënie të mënçura

- - Eshhtë miku im ai që flet mirë për mua pas shpinës sime.
- - Shpenzoni paratë tuaja për gjërat që nuk mund t'i bleni me para. Shpenzoni kohën tuaj për gjërat që nuk mund t'i bleni me para.
- - Nëse do ta kuptonim nëpërmjet arsyes sesa i drejtë dhe i mirë është Zoti, i cili shfaq shumë zemërim dhe ligësi, atëherë për çfarë do të hynte në punë besimi?

